

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY



FAKULTETI JURIDIK
Правен факултет
FACULTY OF LAW

STUDIMET PASDIPLOMIKE-CIKLI I DYTË

Tema e masterit

**Kriminaliteti ekonomik, aspekte krahasuese, me vështrim të posacëm në
Republikën e Kosovës**

Mentori
Prof.Dr.Ismail Zejneli

Kandidati
Qëndrim Zeneli

Tetovë, 2019

Permbajtja

Hyrje.....	4
Qellimi i punimit.....	5
Metodologjia e hulumtimit.....	5
KAPITULLI I.....	6
1. Nocioni i kriminalitetit ekonomik.....	6
2. Historiku dhe paraqitja e kriminalitetit ekonomik.....	7
3. Karakteristikat e përgjithshme të kriminalitetit ekonomik.....	9
4. Kriminaliteti ekonomik-aspekte krahasimore.....	11
4.1 Kriminaliteti ekonomik ne legjislacionin e Republikës së Kosovës.....	11
4.2 Kriminaliteti ekonomik në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë	12
4.3 Kriminaliteti ekonomik në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë	13
4.4 Kriminaliteti ekonomik në legjislacionin e Bosnjës dhe Hercegovinës	15
4.5 Kriminaliteti ekonomik në legjislacionin e Zvicrës.....	15
4.6 Kriminaliteti ekonomik në legjislacionin e Mbretërisë së Bashkuar	16
KAPITULLI II.....	18
1. Shkaqet e Kriminalitetit ekonomik ne përgjithësi.....	18
2. Shkaqet e Kriminalitetit ekonomik ne Republikën e Kosovës.....	20
3. Kryerësit e kriminalitetit ekonomik	20
3.1. <i>Personi fizik si kryerës i kriminalitetit ekonomik</i>	20
3.2. <i>Personi juridik si kryerës i kriminalitetit ekonomik</i>	21
4. Menyra e kryesjes se kriminalitetit ekonomik	23
5. Pasojat e kriminalitetit ekonomik	23
KAPITULLI III.....	25
1. Shpërlarja e parave si formë e kriminalitetit ekonomik	25
2. Shmangia nga tatimi si formë e kriminalitetit ekonomik.....	29
3. Falsifikimi i parasë si formë e kriminalitetit ekonomik	35
4. Mashtrimi i konsumatorëve si formë e kriminalitetit ekonomik.....	38
5. Korrupsioni si formë e kriminalitetit ekonomik	42
6. Kontrabanda si formë e kriminalitetit ekonomik.....	50
KAPITULLI IV	53
1. Luftimi dhe parandalimi i kriminalitetit ekonomik	53

2. Roli i Policisë në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit ekonomik	55
3. Roli i Prokurorise në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit ekonomik	56
4. Roli i Integjences Financiare ne luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit ekonomik	58
5. Rendesia e masave te posacme hetimore ne luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit ekonomik	60
Perfundim	64
Bibliografia	66

Hyrje

Kriminaliteti ekonomik paraqitet si njëra nga format më të avancuara të kriminalitetit të përgjithshëm. Gjatë dekadave të fundit, me fillimin e globalizimit, edhe kriminaliteti ekonomik ka fituar shtrirje të gjerë, duke i shkaktuar ekonomisë globale humbje qindra miliarda dollarë. Kriminaliteti ekonomik paraqitet në forma të ndryshme dhe shpeshherë edhe tepër të avancuara, cka e bën tejet të vështirë zbulimin e tij. Sot shtetet dhe organizatat ndërkombëtare perpiqen vazhdimisht të nxjerrin legjislacionin e duhur dhe të krijojnë mekanizma efikas në mënyrë që të pakësojnë shtrirjen e gjerë që kanë shumë forma të kriminalitetit ekonomik si shpërlarja e parave, korrupsioni apo evazioni fiskal. Në aspektin ndërkombëtar, janë miratuar disa dokumente të rëndësishme ku përcaktohet nocioni i krimit ekonomik, si dhe obligohen shtetet për të marrë masa kundër përhapjes së tij. Ketu duhet cekur si tepër të rëndësishme “Konventa për shpërlarjen e parave, zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë të fituar me vepër penale”, “Konventa e OKB kundër krimit të organizuar transnacional”, “Konventa e Vienës e vitit 1988” etj.

Në literaturën shkencore, ndryshe kriminaliteti ekonomik njihet edhe si krimi i jakës së bardhë. Ky krim definohet si jo i dhunshëm, i motivuar financiarisht dhe i kryer nga njerëz të biznesit dhe administratës publike (nga edhe rrjedh emertimi “krimi i jakave të bardha”). Si forma kryesore që paraqitet kriminaliteti ekonomik janë shpërlarja e parave, korrupsioni (në sektorin publik apo privat), evazioni fiskal, kontrabanda, si dhe mashtrimet e ndryshme në fushën e ekonomisë.

Republika e Kosovës, ndonëse ka hyrë tashme në dekadën e dytë të shtetësisë, ende përballet me një shkallë të lartë të krimit ekonomik dhe korrupsionit. Raportet vendore dhe ndërkombëtare tregojnë se ekonomia joformale në Kosovë është mbi 30 përqind. Indeksi i korrupsionit i organizatës Transparency International në vitin 2018 e radhit Kosovën në vendin e 85, një përparim i vogël në krahasim me vitet e kaluar mirëpo jo i kënaqshëm. Sipas ekspertëve të ekonomisë, niveli i lartë i kriminalitetit ekonomik po e pengon zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të vendit dhe po ndikon në zvogëlimin e të hyrave buxhetore të Kosovës. Sipas tyre shpërlarja e parave dhe krimet e tjera ekonomike dhe financiare, në pjesën

më të madhe konsiderohen të fshehura. E gjitha kjo do të thotë se Republikës së Kosovës i duhen edhe mjaft punë për të bërë në këtë drejtim.

Qellimi i punimit

Në këtë hulumtim do të analizoj dhe interpretoj ligjet aktuale të Republikës së Kosovës dhe vendeve të tjera të rajonit, të cilat sanksionojnë krimet ekonomike, për të kuptuar praktikën më të mirë për luftimin dhe parandalimin e kësaj dukurie. Njohja dhe studimi i kriminalitetit ekonomik është e një rëndësie të veçantë, për shkak se sot kriminaliteti ekonomik është ndër sfidat më të mëdha për ekonomin globale.

Metodologjia e hulumtimit

Për ndërtimin e këtij punimi janë përdorur disa metoda për të arritur në rezultate të sakta lidhur me fenomenin e kriminalitetit ekonomik.

Metoda normative-me anë të së cilës kam studiuar dhe analizuar ligjet dhe akte të ndryshme juridike. Në rend të parë, ka qenë analizimi dhe interpretimi i dispozitave pozitive të legjislativës së Republikës së Kosovës lidhur me kriminalitetin ekonomik, pastaj i ligjeve të vendeve të tjera si dhe dokumenteve dhe akteve ndërkombëtare juridike.

Metoda krahasimore-nëpërmjet së cilës kam bërë krahasimin të ligjeve të ndryshme penale të shteteve të rajonit dhe Europës, konkretisht të kapitujve ku inkriminohen veprat penale nga fusha e ekonomisë.

Metoda kërkimore-ku kam hulumtuar literaturë të autoreve vendore dhe ndërkombëtare, nga fusha e kriminologjisë dhe drejtës penale, për të kuptuar hollësisht fenomenin e krimit ekonomik, zhvillimin e tij historik, karakteristikat e tij dhe metodat me efikasitet për luftimin e tij.

Metoda statistikore-ku kam shfrytëzuar statistika nga Agjencia Kosovare e Statistikave, Prokurori i shtetit dhe Policia e Kosovës, për të kuptuar dinamikën dhe strukturën e kriminalitetit ekonomik

KAPITULLI I

1. Nocioni i kriminalitetit ekonomik

Në shkencën e së drejtës penale paraqiten përkufizime të ndryshme sa i përket nocionit të kriminalitetit ekonomik. Me kriminalitet ekonomik nënkuptojmë të gjitha ato veprime dhe sjellje kundërligjore të personave fizik dhe juridik të cilët janë të kycur në afarizmin dhe veprimtarinë ekonomike. Veprimet kriminale ekonomike, janë ato veprime që pengojnë afarizmin ekonomik ndërsa pjesmarrësve në këtë afarizëm u shkaktojnë dëme të mëdha materiale dhe financiare.¹

Kriminaliteti ekonomik përfshin të gjitha format e aktivitetit kriminal të drejtuar kundër sistemit ekonomik dhe funksionimit të tij. Të gjitha veprimet delikuede (veprime dhe mosveprime), që paraqiten në raportet ekonomike, të cilave me sjellje delikuede drejtpërsëdrejti i shkaktohen pasojat dhe shkelen ose rrezikohen marrëdhëniet ekonomike. Kriminaliteti ekonomik përfshin ato forma të veprimtarisë kriminale që paraqiten në marrëdhëniet ekonomike dhe lidhur me këto marrëdhënie, që janë drejtuar kundër sistemit ekonomik dhe ligjeve të tjera të parapara si vepra penale.²

Si një ndër definicionet më të mira të kriminalitetit ekonomik konsiderohet definicioni i Edwin Sutherlandit (kryetar i shoqatës amerikane për sociologji) nga viti 1939 i cili këtë kriminalitet e konsideron si kriminalitet të jakës së bardhë (White collar crime). Sipas tij, kriminaliteti ekonomik konsiderohet ai kriminalitet i cili paraqitet në sferën e veprimtarisë ekonomike, format e të cilit më së shumti manifestohen gjatë blerjes së aksioneve, reklamimit të rrejshëm të mallrave, pasqyrimin të rrejshëm të gjendjes financiare dhe korrupsionit direkt apo indirekt të nënpunësve shtetëror.³

Në praktikë nuk ekziston një definicion i pranuar ndërkombëtarisht mbi kriminalitetin ekonomik, kështu që ky fenomen definohet në mënyra të ndryshme. Ja disa prej definicioneve:

¹ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2016, fq 195

² Vesel Latifi, Kriminologistika, Prishtinë, 2014, fq 455

³ Edwin H. Sutherland, White Collar Criminality, American Sociological Review, Vol. 5, No. 1 (shkurt., 1940), pp. 1-12

- a) Disa autorë nuk bëjnë ndonjë dallim midis nocioneve kriminalitet ekonomik dhe kriminalitetin e veprimtarisë ekonomike, kështu që me nocionin e kriminalitetit ekonomik ose me kriminalitetin të veprimtarisë ekonomike nënkuptojmë të gjitha ato forma të aktiviteteve kriminale që janë të drejtuara kundër sistemit ekonomik kombëtar dhe funksionimit të tij, pa dallim se a janë nderrmarrë në kuadrin e veprimtarisë ekonomike apo jashtë saj.
- b) Autorë të tjerë bëjnë dallim mes këtyre dy nocioneve, duke marrë për bazë natyrën e marrëdhënieve shoqërore në të cilat shfaqet kriminaliteti, pra edhe në vetë marrëdhëniet dhe proceset. Ata mendojnë se kriminaliteti i veprimtarisë ekonomike është një nocion më i gjerë se ai i kriminalitetit ekonomik sepse përfshin kriminalitetin ekonomik dhe veprat penale kundër obligimeve në ekonomi.
- c) Për definimin e kriminalitetit ekonomik, disa teoricientë nisen nga kriteret e dispozitave penalo-juridike të veprës kundër ekonomisë, ndërsa teoricientë të tjerë nisen nga objekti i mbrojtjes penalo-juridike apo nga vepra e drejtuar kundër organizimit dhe funksionimit të sistemit ekonomik.
- d) Në shumicën e leksikonëve, nocioni kriminalitet ekonomik përfshin të gjitha format e veprimtarive kriminale, të orientuara kundër sistemit ekonomik kombëtar dhe veprimit të tij. Definicionet kriminologjike dhe sociologjike të kriminalitetit janë më të gjera dhe, përveç veprave penale, përfshijnë edhe shkeljet dhe kundërvajtjet në funksionimin e sistemit, si edhe veprat e drejtuara kundër të mirave materiale – me rrezikimin nga jashtë⁴

2. Historiku dhe paraqitja e kriminalitetit ekonomik

Rasti i parë i dokumentuar i krimit ekonomik paraqitet në shekullin XV në Angli, përshkak se Anglia ishte shoqëria e parë e industrializuar, dhe kapitalizmi u zhvillua atje më herët se në vendet e tjera. Në vitin 1473 në rastin *Carrier*, një tregtar hollandez angazhoi një transportues Anglez për të kryer një transport të mëndafshit deri në Southampton. Sidoqoftë, transportuesi Anglez e morri mëndafshin për vete në vend që ta transportonte deri tek destinacioni i duhur. Ai

⁴ Mersida Suceska, Bazat e Kriminalitetit Ekonomik, Prishtinë, 2006, fq 15-16

u arrestua për vjedhje, por gjykata nuk mund ta dënonte për krimin e vjedhjes për shkak se malli ishte nën posedimin e tij të ligjshëm, ngase i ishte dhënë atij nga ana e tregtarit hollandez në menyrë të vullnetshme. Sidoqoftë, gjykatësi vendosi që edhe ndonëse ligji nuk i njeh veprimet e te akuzuarit si vjedhje, prap se prap këto veprime janë të kunderligjshme. Kështu, ky rast bëri të njohur atë që njihet si krim i përvetësimit të paligjshëm.⁵

Por termi krim ekonomik-financiar (krimi i jakave të bardha) daton nga viti 1939. Profesor Edwin Sutherland (Sociolog) ishte i pari që ka shpikur këtë term, dhe ka vënë hipotezën se kriminelët e "jakave të bardha" kanë karakteristika dhe motive të tjera krahasuar me kriminelët tipik të rrugës. Ai ka prezantuar këtë teori duke iu drejtuar Shoqërisë Sociologjike Amerikane (American Sociological Society) në përpjekje të studimit të dy fushave, krimin dhe shoqërinë e lartë, të cilat më parë nuk kanë pasur korrelacion empirik. Ai e definoi idenë e tij si "krim i kryer nga një person i respektuar dhe me status të lartë social gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij". Sutherland kishte shkruar se në këtë kohë, "më pak se dy për qind e personave të burgosur gjatë një viti i takonin klasës së lartë." Qëllimi i tij ishte të vërtetojë lidhjen midis parasë, statusit social dhe gjasave për të shkuar në burg për krimin e "jakave të bardha" krahasuar me krimin më të dukshëm dhe më tipik. Megjithatë përqindja sot është pak më e lartë, numrat akoma tregojnë se shumica e madhe e atyre që janë në burg, janë të varfrit, kriminelët "jakë-blu", përkundër përpjekjeve për të marrë masa energjike ndaj krimit të korporatave.

Sutherland punoi shumë për të ndarë dhe definuar dallimet e krimeve të rrugës të jakave-blu si vrasje, zjarrvënie, vjedhje me thyerje, vjedhje, sulm, dhunim, dhe vandalizëm për të cilat shpesh faji u lihet faktorëve psikologjik, asocial dhe strukturorë. Përkundër kësaj, kriminelët jakë-bardhë janë oportunistët, të cilët me kohë kanë mësuar se mund të përfitojnë nga rrethanat e tyre për të akumuluar përfitime ekonomike financiare. Ata janë të arsimuar, inteligjentë, të pasur, individë të besuar që janë mjaft të kualifikuar për të gjetur një punë e cila atyre u mundëson qasje të pa monitoruar në shumica të mëdha parash. Shumë nga ta gjithashtu shfrytëzojnë inteligjencën e tyre për t'i mashtruar viktimat e tyre për të besuar në kredencialet e tyre. Shumë nga ta nuk fillojnë si kriminelë, dhe në shumë raste ata kurrë nuk e konsiderojnë veten të tillë.

⁵ <https://study.com/academy/lesson/history-of-white-collar-crime-developments-examples.html>

Madje Sutherland nuk ishte i pari që është marr me devijimin e të pasurve, të fuqishmëve dhe të privilegjuarve. Duket se para tij Edward A. Ross ishte ai që kishte raportuar mbi mëkatet e "Kriminoidit" tani artikull klasik në "The Atlantic Monthly" në vitin 1907: "Me këtë ne tregojmë ata që prosperojnë me anë të praktikave tepër të liga që akoma nuk iu kanë nënshtruar ndalimit efektiv të opinionit publik. Në të vërtetë ata shpesh janë fajtorë në sytë e ligjit, por meqë që nuk janë fajtorë në sytë e publikut dhe në sytë e vetë atyre, botëkuptimi i tyre shpirtëror nuk është ai i kriminelit. Albert Morris ishte i pari që shqyrtoi abuzimet e "kriminelëve të botës së sipërme" në formë të një libri. Në trajtimin e tij mbi Kriminologjinë (1935) ai definoi "kriminelët e klasës së lartë" si: "atë grup të numërt por kurrë të definuar qartë të kriminelëve pozita sociale, inteligjenca dhe teknika kriminale e të cilëve u lejon atyre të lëvizin në mesin e bashkë qytetarëve të tyre virtualisht imun për tu njohur dhe ndjekur si kriminelë". Lidhje e përbashkët intelektuale mes Ross-it, Morris-it dhe Sutherland-it ishte imuniteti i një grupi kriminelësh nga procesi juridik për shkak të statusit të tyre social, ekonomik dhe politik; temë kjo të cilën Sutherland-i e kapitalizoi në mbledhjen e mbështetjes publike për idetë e reja të tij.⁶

3. Karakteristikat e përgjithshme të kriminalitetit ekonomik

Kriminaliteti ekonomik, në çfarëdo forme qoftë ai, i ka disa karakteristika të vecanta të cilat në masë të konsideruar dallohen nga ato të kriminalitetit të përgjithshëm. Në rend të parë, sipas konstatimit të disa autorëve, sjelljet kriminale të kriminalitetit të përgjithshëm zakonisht janë transparente, me pasoja të dukshme dhe të prekshme në jetën e përditshme. Personat e dëmtuar me krimin e vjedhjes, plackitjes apo ndonjë krimi tjetër, pasojat e krimit i hetojnë dhe në të shumtën e rasteve edhe kryerësit i indentifikojnë menjëherë. Ndërsa kur është në pyetje kriminaliteti ekonomik, nuk ndodhë kështu, ngase këto krime kryhen në mënyre të fshehtë, vetë kryerja e sjelljeve kriminale ekonomike nuk shkakton përherë ndërrime të dukshme në jetën e përditshme dhe as pasojat e këtyre krimeve nuk janë të drejtperdrejta dhe aq transparente.⁷

⁶ Ilir Islami, Krimi ekonomik-financiar si pengese për zhvillimin e Kosovës, Revista shkencore Juridica, Prishtinë, 2011, fq 130-132

⁷ Ragip Halili, vep e cit, Prishtinë, 2016, fq 196

Rekomandimi i Këshillit të Europës (2000), lidhur me “Parimet udhërrefyese në luftën kundër krimit të organizuar” kanë nxjerrë në pah lidhjen e ngushtë që ekziston ndërmjet kriminalitetit ekonomik dhe kriminalitetit të organizuar, sidomos në fushën e shpërlarjes së parave, korrupsionit dhe mashtrimeve. Grupet e krimit të organizuar krijojnë ndërmarrje kriminale me qëllim kryerjen e krimeve, edhe kur ata investojnë në ekonominë e ligjshme. Krimi ekonomik, në anën tjetër e përdor ndërmarrjen e ligjshme për kryerjen e bizneseve të ligjshme, por duke u mbështetur tek mashtrimet, kartelet, monofolet dhe korrupsioni për të qene i konkureshëm në një treg të ligjshëm.⁸

Për trajtimin e kriminalitetit ekonomik, me rëndësi është që të vecohen edhe disa karakteristika tjera të tij. Përderisa opinioni i gjerë, jo ai profesional, në mënyrë të bujshme dhe të ashper reagon ndaj disa formave të krimit të zakonshëm, të kriminalitetit konvencional si ndaj vrasjeve të rënda, dhunimeve seksuale, vjedhjeve dhe plackitjeve të pasurisë private, në anën tjetër, reagimi ndaj kriminalitetit ekonomik është shumë i butë dhe jo adekuat. Disa autorë, në kërkimet e tyre mbi këtë formë të kriminalitetit dhe duke u bazuar në rezultatet e anketave të zhvilluara, kanë ardhur në përdundim se delikuenti ekonomik, kriminel i disa formave të krimeve ekonomike si psh: mashtrimeve, transaksioneve të ndryshme nga të cilat nxjerr përfitime të mëdha, jo vetem që nuk gjykohet, por në një mënyrë, gezon njëfar simpatie bile në disa raste bëhet edhe njëfar lloj heroi i mjedisit të caktuar, sepse ka treguar mjeshtri e aftësi të vecanta të mashtrorë shtetin apo firmën tjetër dhe të pasurohet pa djersë.⁹

Të gjitha format e kriminalitetit ekonomik, posedojnë disa karakteristika të përbashkëta, të cilat i dallojnë ato nga kriminaliteti i zakonshëm, siq janë:

- Kryhen gjatë aktiviteteve ekonomike dhe si të demtuar paraqiten njëlloj kompanitë private, shteti dhe institucionet financiare.
- Kryhen në menyrë jo të dhunshme, duke përdorur praktika mashtrimi dhe me anë të mjeteve të teknologjisë informative.
- Kryerësit e krimeve ekonomike posedojnë njohuri të specializuara në fushën e ekonomisë dhe financave.

⁸ Këshilli i Europës, Raporti mbi gjendjen e krimit të organizuar dhe krimit ekonomik ne Evropën Juglindore, Strasburg, 2006

⁹ Ragip Halili, vep e cituar, Prishtinë, 2016, fq 198-199

- Motivi i përbashkët i krimeve ekonomike është perfitimi monetar.
- Kriminaliteti ekonomik nenkupton keqpërdorim me besimin dhe praktikat e mira në biznes
- Kriminaliteti ekonomik sjell dëme të mëdha në sferën ekonomike dhe sociale.¹⁰

4. Kriminaliteti ekonomik-aspekte krahasimore

4.1 Kriminaliteti ekonomik në legjislacionin e Republikës së Kosovës

Karakteri specifik i kriminalitetit ekonomik, rrezikshmeria e tij e madhe shoqërore si dhe rritja numrit të veprave penale nga fusha e krimit ekonomik, kërkojnë që kjo problematikë të rregullohet me dispozita të caktuara ligjore.

Veprat penale kundër ekonomisë, në Kodin penal të Republikës së Kosovës, parashihen në kapitullin XXV nga neni 284 deri në nenin 318. Në kete kapitull janë paraparë keto vepra penale të krimit ekonomik: cenimi i barazisë në ushtrimin e veprimtarisë ekonomike, veprimtaria e pandërgjegjshme ekonomike, shkaktimi i falimentimit, shkaktimi i falimentimit të rrejshëm, mashtrimi në procedurën e falimentimit, mashtrimi ose dëmtimi i kreditorëve apo debitorëve, keqpërdorimi i autorizimeve ekonomike, lidhja e kontratës së dëmshme, komunikimi i paautorizuar i sekretit tregtar, falsifikimi i letrave me vlerë dhe instrumenteve të pagesës, falsifikimi i shenjave me vlerë, cenimi i të drejtave të patentës, cenimi i të drejtave të autorit, shmangia e masave teknologjike, mashtrimi i konsumatorëve, mashtrimi i blerësve, organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm, keqpërdorimi i pozitës së monopolit, falsifikimi i parasë, tregtia e ndaluar, prodhimi i ndaluar, shperlarja e parave, shmangia nga tatimi, kontrabandimi i mallrave, shmangia nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore.¹¹

Sa u përket dënimeve, ligjvënësi gjithmonë merr parasysh shkallën e dëmit të shkaktuar nga kryerësi i veprës penale. Si shembull mund të marrim veprën e mashtrimit ose dëmtimit të kreditorëve apo debitorëve (neni 289), ku nëse dëmi i shkaktuar është mbi pesëmijë (5.000) Euro, parashihet dënim me burgim deri në tre (3) vjet. Ndërsa në rastet kur dëmi i shkaktuar

¹⁰ Doktoratura, Ardit Mustafaj, Studim juridiko-penal dhe kriminologjik i kriminalitetit në sferën ekonomike-financiare, Tiranë, 2017, fq 16-17

¹¹ Kodi penal i Republikës së Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i RKS, Prishtinë, 2013

tejkalon dyqind e pesëdhjetëmijë euro (250.000) Euro, kryerësi dënohet me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet. Poashtu tek vepra e organizimit të skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm (neni 300), parashihet dënim me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Ndërsa kur dëmi tejkalon shumën prej njëzetepesëmijë (25.000) Euro parashihet dënim prej dy (2) deri në dymbëdhjetë (12) vjet.

4.2 Kriminaliteti ekonomik në legjislacionin e Republikës së Maqedonisë

Ndryshimet e ngadalshme në Maqedoni pas pavarësis kanë rezultuar me paraqitje masive të veprimeve kriminale të cilat nuk kanë qenë të njohura deri më atëherë. Ky fenomen në vecanti ka ardhur në shprehje gjatë procesit të transformimit të ndërmarrjeve me kapital shtetëror në atë privat. Në këtë proces, duke shfrytëzuar sistuatën e ndërprerjes së këtyre ndërmarrjeve me kapital shtetëror të cilat ndërmarrje krijoheshin situata se këto kanë borxhe të mëdha dhe duke shfrytëzuar këto situata ndaj këtyre ndërmarrjeve doemos duhej të inicohej procedurë falimentimi. Duke shfrytëzuar këto rrethana, këto ndërmarrje bliheshin në kushte shumë të lira, kursa nga blerjet e tilla u krijua një shtresë e caktuar e të përjashtuarve nga puna që emërtoheshin si punëtor falimentues. Këto situata kanë ndikuar që të konstatohet se në Republikën e Maqedonisë si formë dominante e kriminalitetit ekonomik janë transformimet fiktive të shumë ndërmarrjeve me kapital shtetëror në atë privatë, shkaktimi falimentimeve të rrejshme, evazionet tatimore, bishtrimi i ligjeve gjatë importit apo eksportit, transaksionet e palejuara në sferën e qarkullimit pagesor, mashtrimi i komitetëve gjatë kursimeve të tyre, mbajtja e kontabilitetit të dyfishtë, korrupsioni etj.¹²

Në Kodin penal të Republikës së Maqedonisë janë paraparë një numër veprave penale nga fusha e ekonomisë si: Falsifikimi i parave (neni 268), Falsifikimi i letrave me vlerë (neni 269), Larja e parave dhe dobia tjetër e kundersligjshme e pasurisë (neni 273), Leshimi i ceqeve pa mbulëse dhe keqpërdorimi i kartelave pagesore (neni 274), Mashtrimi gjatë punës me letra me vlerë dhe me hise (neni 275), Keqpërdorimi i procedurës për thirrje publike, dhënia e kontratës për furnizimi publik apo partneritetit publiko-privat (275c), Tregtia e palejuar (277),

¹² Ismail Zejneli, *Economic Criminality in Transition Countries- Aspects of the Legal and Economic Analysis*, Rome, Italy, 2013

Kontrabanda (278), Mashtrimi doganor(neni 178-a), Fshehja e tatimit (279),Shkelja e barazisë gjatë kryerjes së veprimtarisë ekonomike (neni 282),pëngimi,kufizimi apo prishja e konkurrencës (neni 283), këqpedorimi i autorizimit në ekonomi (neni 287) etj.¹³

Kodi penal i Republikës së Maqedonisë lidhur me këto vepra ka paraparë dënime të ndryshme.Vepra e penale e falsifikimit të parave dënohet me burgim prej 1 deri ne 10 vite, ndërsa nese me këtë veprim është bërë crregullim i ekonomisë, kryerësi do dënohet me së paku 5 vite.Larja e parave në Kodin penal te RM, dënohet me burgim nga 1 deri në 10 vite, ndërsa nëse vepra në fjalë kryhet gjatë punës bankare apo financiare, ose nese me ndarjen e transaksionit i shmanget obligimit për paraqitje, kryerësi do dënohet me së paku 3 vite.Kur për kryerjen veprës se lartëcekur është krijuar grupi kriminal, kryerësi do dënohet me së paku 5 vite.Vepra penale e fshehja e tatimit dënohet me burgim deri në pesë vite, ndërsa nese shuma e obligimit të shmangur është e rëndësishme kryerësi do dënohet me së paku 4 vite.

4.3 Kriminaliteti ekonomik në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë

Kodi penal shqiptar ka paraparë një sërë veprash penale nga fusha e ekonomisë në kreu e dytë të tij (Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike), i cili është i ndarë në disa seksione, disa prej të cilëve parashohin krime nga fusha e ekonomise ndërsa të tjerët parashohin vepra të zakonshme kundër pasurisë siq është vjedhja apo shkatërrimi i pronës.Ketu do të trajtojmë vetëm ato seksione që parashohin vepra penale nga fusha e ekonomisë.

Seksioni II parasheh veprat penale të mashtrimeve, siq janë: Skemat mashtruese dhe piramidale (neni 143-a), Manipulimi i tregut (neni 143-a-1), Mashtrimi kompjuterik (neni 143-b), Krijimi i skemave mashtruese lidhur me tatimin mbi vlerën e shtuar (neni 144/a), Mashtrimi në sigurime (neni 145), Mashtrimi në kredi (neni 146), etj.

Seksioni IV parasheh vepra penale të kryera në shoqëri tregtare si: Përpilimi i deklaratave të rreme (neni 163), Shpërdorimi i kompetencave (neni 164), Korrupsioni aktiv në sektorin privat (164-a), Korrupsioni pasiv në sektorin privat (164-b), Emetimi i parregullt i aksioneve (neni 166), Dhënia e informacioneve të rreme (neni 168), Zbulimi i sekreteve të shoqërisë (neni 169),

¹³ Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, i miratuar nga Kuvendi i RM, Shkup,1996

Konkurrenca e paligjshme nëpërmjet dhunës (neni 170) etj.

Seksioni IV-I parasheh vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare të cilat janë: Ushtrimi pa licencë i veprimtarisë bankare (neni 170-c) dhe Ushtrimi pa licencë i veprimtarive financiare (neni 170-c).

Seksioni V parasheh vepra penale nga fusha e doganave si: Kontrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara (neni 171), Kontrabanda me mallra të licencuara (neni 173), Kontrabanda me mallra të tjera (neni 174), Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë (neni 178) etj.

Seksioni VI parasheh vepra penale nga fusha e tatimeve si: Fshehja e të ardhurave (neni 180), Mospagimi i taksave dhe tatimeve (neni 181), Ndryshimi në aparatet matëse (neni 182) etj.

Seksioni VII parasheh vepra penale të falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë si: Falsifikimi i monedhave (neni 183), Falsifikimi i letrave me vlerë (neni 184) dhe Prodhimi i mjeteve për falsifikim (neni 185).

Seksioni IX parasheh vepra penale nga fusha e falimentimit si: Falimentimi i provokuar (193), Fshehja e gjendjes së falimentimit (neni 194), Fshehja e pasurisë pas falimentimit (neni 195) dhe Shkelja e detyrimeve (neni 196).

Seksioni X parasheh vepra penale nga fusha e lojrave të fatit si: Organizimi i lotarive të palejuara (neni 197), Paracaktimi i rezultateve në garat sportive (neni 197-a), Shtrembërimi i konkurrencës në garat sportive (neni 197-b), Vënia në dispozicion e lokaleve për lojëra të palejuara (neni 198).¹⁴

Kodi penal shqiptar gjatë përcaktimit të denimeve për krime ekonomike merr parasysh gjithmonë pasojat e shkaktuara dhe lartësinë e dëmit. Psh vepra penale e skemave piramidale dhe mashtruese dënohet me 3 deri në 10 vite, ndërsa kur sjell pasoja të rënda me 10 deri në 20 vite. Sa i përket korrupsionit, kodi penal shqiptar korrupsioni aktiv e dënon me burgim deri në tre vite ndërsa atë pasiv deri në 5 vite. Tek fshehja e tatimeve, ky kod merr parasysh lartësinë e tatimit të fshehur. Vepra bazë e fshehjes së tatimit dënohet deri në 3 vite, ndërsa kur shuma e tatimit të fshehur kalon shumë në 5 milion lekë kryerësi dënohet deri në 5 vite, e në rastet kur kjo shumë është mbi 8 milion lekë, kryerësi mund të dënohet deri në 8 vite. Falsifikimi i parave

¹⁴ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1991

dënohet me burgim deri në 5 vite, ndërsa kur kjo vepër sjell pasoja të rënda dënohet me burgim deri në 15 vite.

4.4 Kriminaliteti ekonomik në legjislacionin e Bosnjës dhe Herzegovinës

Kodi Penal i Bosnjës dhe Herzegovinës veprat penale nga fusha e ekonomisë i parasheh në kapitullin XVIII si në vijim: Cenimi i barazisë në kryerjen e veprimtarisë ekonomike (neni 204), Falsifikimi i parave (neni 205), Falsifikimi i letrave me vlerë (neni 206), Falsifikimi i shenjave të vlerës (neni 207), Falsifikimi i shenjave për shenjimin e mallrave, masave dhe peshojave (neni 208), Larja e parave (neni 209), Fshehja e tatimit (neni 210), Mospagesa e tatimit (neni 211), Tregtia e palejueshme (neni 212), Prodhimi i palejueshëm (neni 213), Kontrabanda (neni 214), Organizimi i grupit të njerëzve ose bashkimi për kontrabandë ose për shpërndarje të mallit të pa doganuar (neni 215), Mashtrimi doganor (neni 216).¹⁵

Sa u përket dënime, merret gjithmonë parasysh lartësia e dëmit. Psh për veprat penale falsifikim i parave dhe falsifikim i letrave me vlerë, lartësia e dënimit është nga 1 deri në 10 vite, ndërsa në rastet kur me kryerjen e kësaj vepre shkaktohen pengesa në ekonominë e Bosnjës dënimi minimal përcaktohet 5 vite. Për veprën larje e parave, dënimi është nga 6 muaj deri në 3 vite, ndërsa nëse vlera e pasurisë është mbi 50.000 KM parashihet dënim nga 1 deri në 10 vite. Tek vepra e shmangies nga tatimi, dënimi parashikohet poashtu sipas lartësisë së obligimeve të shmangura. Nëse shuma obligimeve të shmangura është më e lartë se 10.000 KM kryerësi do dënohet me gjobë ose burgim deri në 3 vite, nëse shuma e obligimeve të shmangura është mbi 50.000 KM dënimi varion nga 1 deri në 10 vite, ndërsa në rastet kur shuma e obligimeve të shmangura kalon 200.000 KM atëherë kryerësi dënohet së paku me 3 vite.

4.5 Kriminaliteti ekonomik në legjislacionin e Zvicrrës

Kodi penal zviceran, shumicën e veprave penale nga fusha e ekonomisë i ka paraparë në titullin e dytë të tij, ku parashihen veprat kundër pronës. Disa vepra nga fusha e ekonomisë të parapara në këtë kod janë: përdorimi i paligjshëm i aseteve financiare (neni 141), Mashtrimi

¹⁵ Kodi Penal i Bosnjës dhe Herzegovinës, i miratuar nga Kuvendi i BeH, Sarajeve, 2003, i amendamentuar përsëri në vitin 2015

(neni 146), Mashtrimi kompjuterik (neni 147), Keqpërdorimi i ceqeve dhe kartave të kreditit (neni 148), shkaktimi i humbjes financiare personit tjetër (neni 151), deklaratat e rreme lidhur me biznesin (neni 152), veprat lidhur me falimentimin (neni 163), shpërlarja e parave (neni 305) etj.¹⁶

Sa u përket dënimeve, edhe Kodi penal zviceran merr parasysh disa elemente si motivi i kryerësit apo lartësia e dëmit. Psh për veprën penale të mashtrimit dënimi bazik është deri në 5 vite, mirëpo nese motivi i kryerësit është fitimi komercial atëherë lartësia e dënimit është deri në 10 vite. Tek vepra e larjes së parave parashihet dënim deri në 3 vite, ndërsa nese në raste serioze, kodi penal parasheh dënim deri në 5 vite.

4.6 Kriminaliteti ekonomik në legjislacionin e Mbretërisë së Bashkuar

Pjesa më e madhe e krimeve të mashtrimeve financiare janë të përfshira në *Fraud act* 2006 (Ligji mbi mashtrimet) si edhe në *Theft act* (Ligji mbi vjedhjet). Krime të tjera janë të parashikohen në statute të tjera nga legjislacioni i taksave dhe ai i korporatave. *Fraud act* përmban tri lloje të veprave penale të mashtrimit.

- a) Mashtrimi nga përfaqësimi i rremë (seksioni II)
- b) Mashtrimi duke dështuar të zbulojë informatat atëherë kur ekziston një detyrim ligjor për ti zbuluar ato (seksioni III)
- c) Mashtrimi nga shpërdorimi i pozitës (seksioni IV)

E përbashkët për të tre veprat penale të mashtrimit është kërkesa që personi të veprojë në mënyrë të pandershme, duke synuar të fitojë për vete ose për një tjetër person ose për të shkaktuar humbje një personi tjetër (ose ekspozojnë një tjetër në një rrezik të humbjes). Ndërsa *Theft act* përmban veprat penale të:

- a) Kontabilitetit të rremë (seksioni 17)

¹⁶ Kodi Penal i Zvicres, i miratuar nga Asambleja Federale e Konferderates Zvicerrane, Bernë, 1937

b) Deklarata të rreme nga drejtoret e kompanive (seksioni 19)¹⁷

Shpërlarja e parave në Mbretërinë e bashkuar rregullohet nga katër akte kryesore juridike:

- *Terrorism act 2000* (Ligji mbi terrorizmin)
- *Anti terrorism, Crime, Security act 2002* (Ligji mbi anti terrorizmin, krimin dhe siguinë)
- *Proceeds of Crime Act 2002* (Ligji mbi të ardhurat nga veprimtaria kriminale)
- *Serious Organised Crime and Police act 2005* (Ligji mbi Krimiet serioze të organizuara dhe policin)

Proceeds of Crime Act paraqet aktin kryesor kundër shpërlarjes së parave në legjislacionin e Mbretërisë së bashkuar. Ky akt përmban dispozita që obligojnë institucionet financiare ti raportojnë autoriteteve, cdo dyshim për shpërlarje parash nga klientet e tyre apo persona të tjerë.

¹⁷ Financial crime in the UK (England and Wales):overview by Christopher David, Alison Geary, David Rundle, Lloyd Firth, Leila Gaafar, Fred Saugman, and Anna Gaudoin, Wilmer Hale

KAPITULLI II

1. Shkaqet e Kriminalitetit ekonomik ne përgjithesi

Kriminaliteti ekonomik paraqitet në të gjitha fushat e veprimtarisë ekonomike, duke filluar nga afarizmi i depozitimit, nëpërmjet prodhimit, afarizmit të arkës, sektorit komercial, tregtisë së jashtme, shitoreve tregtare dhe hoteliere, sektorëve ekonomiko-llogaritarë, deri tek udhehqja e përgjithshme. Shkaqet themelore që kushtëzojnë paraqitjen e këtij lloji të kriminalitetit janë: forma e raportit ndaj pasurisë së organizatës punuese, format e pasurisë, shkalla e koncentrimit të funksioneve, zhvillimi dhe arsyeshmëria e sistemit mbrojtës, pozita afariste e organizatës punuese, zhvillimi i organizimit të qeverisjes dhe aftësia profesionale e intelektuale e kryerësit. Edhe pse faktorët objektivë kanë rëndësi qendrore në drejtim të paraqitjes dhe kushtëzimit të strukturës së caktuar të kriminalitetit ekonomik, profesionaliteti dhe aftësia intelektuale, si faktorë subjektivë, në raste të caktuara, mund të jenë vendimtar, në kryerjen e veprave penale të kriminalitetit ekonomik.¹⁸

Depërtimin e kriminalitetit të organizuar ekonomik në planin ndërkombëtar i kanë ndihmuar“

- globalizimi i rrjedhave financiare, shpejtësia me të cilën bëhen transaksionet financiare dhe dominimi i dollarit amerikan dhe EORO-s në këmbimin financiar global;
- zhvillimi i qyteteve të mëdha kosmopolitane, të cilat janë bërë qendra të sistemit ekonomik e financiar global, arkat e kapitalit dhe pasurisë dhe pikat kryesore të transportit e komunikacionit për transaksione ndërkombëtare (qendrat që kanë rol të rëndësishëm në lehtësimin e transaksionit të karakterit global, janë njëkohësisht qendra të transaksionit ilegal);
- zhvillimi i shoqërisë post-industriale dhe revolucioni informativ;
- rënia e sistemit komunist dhe gara tronditëse për futjen e kapitalizmit të tregut liberal, pa ekzistimin e mekanizmave themelore rregullativë dhe normave të sjelljes;¹⁹

¹⁸ Vesel Latifi, Kriminialistika, Prishtinë, 2012, fq 457

¹⁹ Mersida Sucecka, vep e cituar, Prishtinë, 2006, fq 40

Sikurse tek kriminaliteti i përgjithshëm edhe tek kriminaliteti ekonomik, shkaktarët ndahen në dy kategori kryesore, shkaqet objektive dhe subjektive. Si shkaqe objektive (të jashtme) konsiderohen:

- 1) Industrializimi-përvec dobive të mëdha që i ka sjellë shoqërisë, në të njëjten kohe ka qenë shkak për paraqitjen e shumë formave të kriminalitetit ekonomik. Disa forma të kriminit ekonomik në përgjithësi i hasim në vende të industrializuara siq janë shmangia nga tatimi, mashtrimi me konsumatorë, ryshfeti etj.
- 2) Varfëria dhe papunësia-padyshim se ndikojnë në rritjen e numrit të krimeve ekonomike. Në ato vende ku shkalla e papunësisë dhe varfërisë është e lartë, në të njëjten kohë edhe shkalla e kriminalitetit ekonomik paraqitet tejet e lartë dhe vecanërisht disa formave si kontrabanda dhe ryshfeti.
- 3) Profesionit-gjithashtu konsiderohet si shkak i paraqitjes së kriminalitetit ekonomik. Personat që punojnë në profesione si kontabilistëve, bankierëve, furnizuesve posedojnë njohuri më të mëdha profesionale dhe e kanë me të lehtë kryerjen e disa krimeve si pastrimi i parave, shmangia nga tatimi dhe falsifikimi.

Ndërsa si shkaqe subjektive që mendohet se ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit ekonomik mund të përmendim:

- 1) Intelejencia-studimet tregojnë se personat me shkallë më të lartë të intelegjencës paraqiten si kryerës të krimeve ekonomike, për dallim nga krimet e zakonshme, ku cdoherë është menduar se kryhen nga persona me një nivel më të ulët intelegjence. Kjo ngase për kryerjen e krimeve ekonomike si shpërlarja e parave, shmangia nga tatimi, falsifikimi i parave padyshim se nevojiten njohuri nga fusha e kontabilitetit, financave dhe jurisprudencës.
- 2) Motivi material-është motivi kryesor që shtyn personat në kryerjen e krimeve ekonomike, pra më qëllim të përfitimit të dobisë pasurore.

2. Shkaqet e Kriminalitetit ekonomik ne Republikën e Kosovës

Pavarësisht se renditja e shkaqeve të kriminalitetit ekonomik dhe korrupsionit gjithmonë është në evoluim, do të përqipem ti paraqesim disa shkaqe që kushtëzojnë paraqitjen e kriminalitetit ekonomik në Kosovë. Ndër to mund të përfshijmë keto:

- *Mosfunksionimi i ligjit dhe sistemit të drejtësisë*
- *Mungesa e legjislacionit efikas*
- *Gjendja e rëndë ekonomike dhe sociale*
- *Morali i dobët*
- *Periudha e tranzicionit*
- *Lufta si faktor kriminogjen*
- *Pagat e vogla të nënpunëve shtetëror*
- *Dëshira për pasurim të shpejtë*

3. Kryeresit e kriminalitetit ekonomik

3.1. *Personi fizik si kryerës i kriminalitetit ekonomik*

Kryerës të veprave penale kundër ekonomisë mund të jenë personat e ndryshëm, në disa raste, veprat penale të ekonomisë i kryejnë të gjithë personat, ndërsa disa vepra penale të kundërligjshme nga sfera e ekonomisë mund ti kryejnë vetëm një kategori e personave.

Kryerësit e krimeve ekonomike dhe krimeve të organizuara në ekonomi, në shoqërinë bashkëkohore rëndom nuk janë tipa asocialë ose nuk duken si të tillë. Ata nuk përdorin dhunën fizike sic veprojnë rëndom kriminelët e nëntokës dhe të dhunës klasike. Këta kriminelë, në shikim të parë, në asnjë cilësi të jashtme nuk u përngajnë kriminelëve që zakonisht opinioni i konsideron të tillë. Përkundrazi këta individë, në të shumtën e rasteve trajtohen si qytetarë të respektuar dhe afaristë të sukseshëm.

Në literaturën kriminologjike bashkëkohore, kryerësit e kriminalitetit ekonomik, shpeshherë ndahen në disa shtresa. **Shtresën e parë** e përbëjnë të ashtuquajturit kriminelë ose “njerëz të

imtë".Qëllimi i tyre është sigurimi i një ekzistence të domosdoshme jetësore e jo grumbullimi i parave dhe kapitalit të madh.Kjo është e ashtuquajtura shtresë e ulët e kriminalitetit ekonomik.**Shtresën e dytë** ose të mesme të kriminelëve ekonomike, përfshin kategorinë e personave që janë të motivuar të grumbullojnë pasuri, të arrijnë një status material ekonomi më të lartë dhe me këtë të realizojnë edhe disa privilegje politike dhe ndikime të tjera në botën afariste.Këta kriminelë, zakonishtë lëshohen edhe në manipulime, transaksione dhe në spekulime të llojllojshme, në bursë, tregti, banka dhe mashtrime të tjera.Ketu vecmas vërehet angazhimi i tyre në korrupsionin e segmenteve të ndryshme të pushtetit administrativ policor, gjyqësor dhe politik.**Shtresën më të lartë** të kryerësve të kriminalitetit ekonomik e përbërjnë personat që zënë pozita të larta ekonomike dhe politike.Shpesh këta persona mbajnë pozita të rëndësishme në strukturat e partive politike, ministrivë të ndryshme, në sektorët e ekonomisë, bankave, marrëdhënieve tregtare me botën e jashtme ose gjenden vetë në segmente ku bëhen investime të mëdha ose i kanë njerëzit e vet.Në këtë menyrë ata kanë mundësi që gati legalisht e pa veshtirësi të sigurojnë informata, programe, kredi, licensa, lehtësi dhe favorizime të tjera.²⁰

3.2. Personi juridik si kryerës i kriminalitetit ekonomik

Personat juridik paraqesin formë të institucionalizuar të veprimit të përbashkët të më tepër personave fizik.Nëse personi juridik përbëhet nga dy apo më tepër persona fizik, atëherë përgjegjësia eventuale penale e tij, në të vertetë do të thotë përgjegjësi kolektive të secilit anëtarë të personit juridik, ndërsa sanksioni që do ti shqiptohej eventualisht personit juridik do të prekte gjithashtu secilin anëtarë të tij.Nga ana tjetër, përgjegjësia e tillë e hap problemin e përgjegjesisë konkurrenente gjegjësisht paralele të personit juridik dhe personit fizik me veprimin e të cilit është kryer vepra penale.

Rreth pozitës së personave juridik në të drejtën penale tradicionalisht ndeshen dy koncepte: teoria e fiksionit apo teoria romanistike dhe teoria e realitetit apo teoria gjermane

²⁰ Ragip Halili, vep e cituar,Prishtinë,2016,fq 199-201

(organike). Sipas të parës, personi juridik është fikSION i thjeshtëm edhe atë ligjor, vetëm personat fizik janë subjekte të drejtësisë, mirëpo ligji një grupi të personave u jep cilësinë e subjekteve të së drejtës. Personi juridik nuk ka vullnetin e tij, kështu që nuk mund të përgjigjet për veprimet e anëtarëve apo përfaqësuesve të tij.

Teoria e fikSIONIT sot, ja lëshon vendin e vet teorisë së realitetit. Personat juridik bëhen pjesmarrës të rëndësishëm në jetën e përgjithshme dhe kryejnë funksione ekonomike dhe funksione të tjera. E drejta penale nuk mund të mbështetet mbi fikSIONE, ndërsa në anën tjetër, duke u ballafaquar me fenomenin e krimit kolektiv dhe me format e tij të reja sic janë, kriminaliteti ekonomik transnacional, malverizimet e ndryshme devizore, doganore dhe financiare, nuk mund të ngelë në sferën e përgjegjësisë penale individuale. Nevoja për dënimin e personave juridik arsyetohet me rëndësinë e tyre gjithnjë e më të madhe si subjekte themelore në jetën juridiko-ekonomike dhe pranimi i cilësisë së qënieve reale, me të drejta dhe përgjegjësi dhe aftësi afariste.²¹

Obligimi për përcaktim të përgjegjësisë penale të personave juridik përfshihet në më tepër konventa ndërkombëtare që kanë të bëjnë me format e reja të krimit: krimit të organizuar, korrupsionit dhe shpërlarjes së parave në të cilat hyjnë edhe veprat e krimit korporativ. Obligim të tillë eksplicit parasheh edhe Konventa e Palermos: shtetet janë të obliguara të parashohin përgjegjësinë penale për personat juridik për pjesmarrje në krim serioz që involvon grup të organizuar kriminal si dhe për larjen e të ardhurave nga krimi. Përgjegjësia e personit juridik nuk varet nga përgjegjësia e personit fizik që e ka kryer veprën penale. Ndryshimet në legjislacione janë nxitur edhe nga përcaktimet e BE të përmbajtura në Konventën për mbrojtjen e interesave financiare të BE të vitit 1995 dhe në disa direktiva të vecanta. Konventa përmban dispozitë të posacme për përgjegjësinë penale të personave juridik për mashtrime financiare dhe larjen e parave, në të cilën së pari përcaktohen prezumimet për përgjegjësinë e organeve të personit juridik e pastaj përcaktohet përgjegjësia edhe për vepra të të punësuarve në personin juridik të kryera në favor të personit juridik. Propozimi i Corpus Juris (e drejta penale ekonomike e BE) nga viti 1998 gjithashtu përmban dispozitën për përgjegjësinë penale të personave juridik, që

²¹ Ismail Zejneli & të tjerë, Kriminialiteti i organizuar-aspekte juridike, Tetovë, 2009, fq 39-40

aktivizohet me veprimet e organeve, përfaqësuesve apo personave tjerë që veprojnë në emër të personit juridik, apo kanë mundësi ligjore apo faktike të vendimarrjes.²²

4. Menyra e kryejes se kriminalitetit ekonomik

Neni 8 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, parasheh se vepra penale mund të kryhet me veprim ose mosveprim. Tek kriminaliteti ekonomik, pjesa më e madhe e krimeve kryhen me veprim, ndonëse në disa raste paraqitet mundësia e kryerjes së vepres penale me mosveprim, psh tek rastet e mosdeklarimit të tatimit apo moslëshimi i dokumenteve lidhur me tatimin. Në këto raste kryerësi nuk ndërmerr veprimin që ka qenë i obliguar ta ndërmarrë sipas ligjit, psh dorëzimi i një deklarate mbi të ardhurat pranë organit tatimor.

Sa i përket menyrës së kryerjes së veprimit, atë e dallojnë disa karakteristika nga krimi i zakonshëm. Krimet ekonomike gjithmonë kryhen në fshehtësi dhe kryerësit cdoherë ndërmarrin të gjitha masat e mundshme që të mos zbulohen në të ardhmen. Poashtu për kryerjen e këtyre veprave sic është cekur dhe më lartë kerkohen dije dhe njohuri profesionale të cilat jo cdo njeri mund ti posedojë. Psh për kryerjen e shpërlarjes së parave, nevojiten domosdo njohuri nga ligjet dhe rregullat bankare, për kryerjen e shmangies nga tatimi nevojiten njohuri nga kontabiliteti dhe ligjet fiskale, ndërsa për disa vepra si falsifikimi i parave nevojiten edhe njohuri të shkencave teknike në mënyrë që të kryhet printimi i parasë së rrejshme.

5. Pasojat e kriminalitetit ekonomik

Kostoja e kriminalitetit ekonomik është shumë e larte dhe efektet e tij janë shkatërrues për shoqërinë. Ai pengon zhvillimin e një tregu normal dhe frenon zhvillimin ekonomik dhe social të një vendi. Më së tepërmi të prekura janë vendet në zhvillim, ku bën pjesë edhe Kosova. Sidomos korrupsioni si një formë e kimit ekonomik, i cili në vend të konkurrencës në cilësi, inkurajon konkurrencën në ryshfete.

²² Ismail Zejneli & të tjerë, vep e cituar, Tetovë, 2009, fq 43-44

Sa u përket pasojave ekonomik dhe sociale të korrupsionit autori Luan Gjonca i ka përmbledhur në mënyrë shumë profesionale si në vijim:

- Korrupsioni ndikon në mospërdorimin me efektivitet të burimeve ekzistuese të një shteti duke përfshirë edhe ato të karakterit natyror.
- Korrupsioni shkatërron ekonominë. Synimi i tij është të bëhet pjesë në strukturat drejtuese të ekonomisë dhe kur ai arrin të sistemohet, krijon situata të vështira për këto struktura të infektuara dhe për popullatën, pasi do të pasojë rritja e pajustificuar e kostos së mallrave dhe të shërbimeve mbi vlerat reale normale të tyre.
- Sjell rritjen marramendëse të borxheve shtetërore. Kjo dukri është karakteristike, sidomos për vendet me prapambetje relative ekonomike apo edhe në ato me zhvillim, sic është vendi ynë.
- Dëmton sferën e investimeve, sidomos atyre me kapital të huaj, për të cilat dihet roli që luajnë për ekonominë e një vendi. Ndikimi i korrupsionit në sferën e investimeve shfaqet në dy rrafshë: së pari krijon barrierën e parë dhe shpeshherë të pakalueshme për këto investime, dhe së dyti, ndikon në rritjen e kosotos së projekteve investuese, që në fund të fundit do të sjellë mos realizimin e tyre.
- Krijimi dhe zgjerimi i ekonomisë informale, sjell rritjen e dukshme të veprave kriminale, në lëmin e tatim-taksave dhe mosvjeljen e përdorimit të tyre, që dobëson buxhetin e shtetit. Në këto kushte, shteti privohet nga mekanizmi kryesor për drejtimin e ekonomisë dhe crregullimet e kësaj natyre gjithmonë ashpërsojnë problemet sociale, për shkak të mosplotësimit të kërkesave të parashikuara, fillimisht në buxhetin shtetëror.
- Godet të drejtën dhe diskreton sistemin e drejtësisë, që është sistem kryesor për rregullimin e marrëdhënieve të shoqërisë dhe shtetit.
- Krijon gjendje pasigurie dhe frikë në ndërgjegjen shoqërore ndaj krimit, krimineleve dhe njerëzëve të veshur me petkun e pushtetit.
- Zhvleftëson rolin dhe bashkëpunimin me shoqërinë civile.²³

²³ Luan Gjonca, Korrupsioni, Tiranë, 2004, fq 218

KAPITULLI III

1. Shpërlarja e parave si formë e kriminalitetit ekonomik

Me shpërlarje te parave kuptohet procesi i fshehjes së burimeve ilegale të te hyrave, të realizuar nëpërmjet veprave penale, me qëllim të futjes së këtyre të ardhurave në rrjedhat e afarizmit legal financiar. Me termin “shpërlarje e parave” kuptohet gjithashtu posedimi, fitimi, këmbimi, bartja ose shfrytëzimi, e cila është krijuar me veprime kriminale ose me pjesmarrje personale në këso veprimesh, me qëllim të fshehjes së pasurisë me prejardhje të kundërligjshme ose me ofrimin e ndihmës ndonjë personi që është përzier në veprimtari të tilla, me qëllim të evitimit të pasojave ligjore të parashikuara me dispozitat e Kodit Penal.²⁴

Gjatë shpërlarjes së parave tentohet që të bëhet fshehja e ilegalitetit të burimeve dhe përdorimit të të hyrave që janë rezultat nga këto burime për qëllime të caktuara (legalizimin e të hyrave jo legale). Mashtrimi paraqet esencën e tërë veprimit gjatë larjes së parave, pasi që gjatë tërë veprimit tentohet që mjetet e caktuara të tregohen si legale me qëllim që të mund të futen në qarkullim. Në esencë, shpërlarja e parave si veprim kriminel përfshin dy lloje të veprimeve : së pari, tentohet që parat jo legale të futen në ndonjë institucion bankarë në llogari të ndonjë personi fizik apo juridik dhe kështu të bëhen legale dhe, së dyti këto para legale të mund të shfrytëzohen për qëllime të caktuara.²⁵

Procesi fizik i shpërlarjes së parave ndahet në tri faza: faza e parë përfshin instalimin apo transferimin fizik të parave të cilat janë fituar si rezultat i veprimtarisë kriminale. Faza e dytë përfshin mbulimin apo shtresimin duke u kycur në transaksione financiare komplekse për të humbur gjurmët dhe rrugët e fitimit të parave të cilat janë mbledhur në mënyrë jo ligjore. Faza e tretë përfshin përpjekjen dhe angazhimin që këto para të “papastra” të paraqiten si formë e pasurisë dhe kapitalit të ri, të pastër, legjitim, me qëllim të kycjes së deponimit të tij në

²⁴ Veton Vula, Kriminaliteti i organizuar, Prishtinë, 2013, fq 125

²⁵ Adnan Jashari, Ismail Zejneli, Disa vështrime në lidhje me kriminalitetin ekonomik në Maqedoni në periudhën e tranzicionit, Revista “ E drejta”, Prishtinë, 2011, fq 1-9

aktivitete të mirëfillta ekonomike e financiare.²⁶

Zhvillimi i hovshëm i teknologjisë, komunikacionit dhe informacionit financiar ka mundësuar qarkullimin e shpëjtë dhe të lehtë të parasë neper botë. Kjo bën luftimin e shpërlarjes së parave më urgjent se kurdoherë. Shuma e parave të pastruara brenda një viti në botë paraqet dy deri në pesë përqind të GDP globale, apo 800 miliardë deri në dy trilion dollarë amerikan.²⁷

Thuhet se vetëm në Shtetet Bashkuara të Amerikës brenda një viti shpërlahen 500 miliard dollar, nga e cila shumë tregtisë me narkotik i takojnë 70 miliard dollar. Tregtia Botërore me narkotik zgjerohet në treg në masë prej 500 miliard dollarë dhe është në majë të veprimtarisë kriminale. Vetëm sa për krahasim, kjo sasi e masës së të hollave është dy herë më e lartë se prodhimtaria farmaceutike. Andaj, shpërlarja e parave si dukuri negative paraqet kërcënim serioz për institucionet financiare të një vendi dhe më gjer, me ç' rast subjektet ekonomike të cilat veprojnë në suaza të dispozitave ligjore, vihen në pozitë të pa lakmueshme. Sipas Këshillit të Europës "Globalizimi i financave në treg ka sjellë qarkullimin e shumave aq të mëdha të parave sa paratë që lahen mund të përzihen në mënyrë të pavërejtur dhe të papenguar me paratë legale"²⁸

Shpërlarjen bashkëkohore të parave e karakterizojnë veprime si:

- a) Avancimi i vazhdueshëm i mënyrave të larjes së parave me zbatimin e të gjitha teknikave dhe metodave të sofistikuar.
- b) Investimi i madh i mejteve të fituara nga narkotikët, terrorizmi dhe veprimet tjera të paligjshme në veprimtari të ligjshme, me qëllim të shtimit të shumës së parave dhe më qëllim të maskimit të qarkullimit të parave.
- c) Përzierja e parave të ligjshme dhe parave të paligjshme me qëllim që të evitohet rënien në gjurmë të parave të paligjshme, gjatë revizionit të organeve hetuese zyrtare.
- d) Shtimi i aktiviteteve për larjen e parave të tregtarët e aksioneve, të cilët përdorin para të paligjshme.²⁹

²⁶ Ragip Halili, vep e cituar, Prishtinë, 2016, fq 150

²⁷ <https://ëëë.unodc.org/unodc/en/money-laundering/globalization.html>

²⁸ Mersida Suceška, vep e cituar, Prishtinë, 2006, fq 155

²⁹ Veton Vula, vep e cituar, Prishtinë, 2013, fq 130-131

Institucione të përshtatshme për larjen e parave janë:

- Bankat dhe kursimoret;
- Fondet investuese, shoqëritë investuese dhe organizatat tjera financiare:
- Organizatat për qarkullimin e pagesave;
- Organizatat të cilat e udhëheqin procedurën e privatizimit;
- Shoqëritë e sigurimeve;
- Berzat dhe organizatat tjera që merren me qarkullimin e letrave me vlerë:
- Këmbimoret;
- Organizatat për punësim;
- Organizatat që merren me lojëra të ndryshme;
- Personat juridike ose fizikë që merren me veprimtari lidhur me këto punë:
 - shitjen dhe pagesën e borxheve;
 - administrimin e pasurisë për persona të tretë;
 - lëshimin e kartelave të parave kesh dhe të kartelave kreditore;
 - organizimin e udhëtimeve;
 - qarkullimin e patundshmërive;
 - ruajtjen në arka (sefa)
 - qarkullimin e metaleve fisnike dhe gurëve të çmuar dhe përpunimin e tyre³⁰

Republika e Kosovës ka miratuar Ligjin për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, me anë të cilit parashikohen dënimet, organet kompetente dhe procedura për zbulimin dhe parandalimin e shpërlarjes së parave.

Në nenin 56 të Ligjit për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit është paraparë vepra penale e shpërlarjes së parave si në vijim:

Kushdo që, duke e ditur ose ka arsye për të ditur se pasuria e caktuar buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal, pasuri kjo e cila në të vërtetë fitohet me vepër penale, apo kushdo që duke besuar se pasuria e caktuar fitohet nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal bazuar në përfaqësimet e bëra si pjesë e një hetimi zbulues të zhvilluar në pajtim me Kapitullin IX të Kodit të procedurës penale të Kosovës,

³⁰ Mersida Suceska, vep e cituar, Prishtinë, 2006, fq 160

zhvillon veprimet e mëposhtme, kryen vepër penale të dënueshme me burgosje deri në dhjetë (10) vjet dhe me gjobë deri në tri (3) herë më të madhe në vlerë të pasurisë e cila është subjekt i veprës penale, si vijon:

1.1. Konverton, transferon ose përpiqet të konvertoj ose të transferojë pasurinë me qëllim të fshehjes apo të maskimit të natyrës, burimit, vendit, dispozicionit, lëvizjes ose pronësisë së pasurisë;

1.2. Konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë ose të transferojë pasurinë me qëllim të ndihmës së personit i cili është i përfshirë në të ose që, siç pandehet, është i përfshirë në kryerjen e veprës penale që ka shkaktuar shmangien e pasojave ligjore apo të pasojave të qarta ligjore të veprimeve të tij;

1.3. Konverton, transferon ose përpiqet të konvertojë ose të transferojë pasurinë me qëllim të nxitjes së aktivitetit të ndërlidhur kriminal;

1.4. Merr, posedon, shfrytëzon apo tenton të merr, posedojë apo shfrytëzojë pasurinë;

1.5. Fsheh ose maskon natyrën e vërtetë, burimin, vendndodhjen, sistemimin, lëvizjen, të drejtat në lidhje me, apo pronësinë e pasurisë, ose nga një akt i pjesëmarrjes në veprimtari të tilla;

1.6. Merr pjesë në, bashkëpunon dhe ndihmon për të kryer, nxit, lehtëson dhe këshillon në kryerjen e ndonjë prej veprimeve të përmendura në nën-paragrafët 1.1 deri në 1.5. të këtij paragrafi.³¹

Duke marrë parasysh këtë përcaktim ligjor të veprës penale, mund të konkludojmë se duhet të ekzistojnë keto elemente për tu konsideruar se është kryer vepra penale e shpërlarjes së parave:

- Ka pasur konvertim apo transferim pasurish-ligji nuk duket se kufi zon mënyrën, në të cilën pasuritë konvertohen ose transferohen. Sigurisht që çdo lloj transaksioni financiar, si: depozita bankare, blerja e një çeku të arkëtueshëm, këmbimi i një çeku me një tjetër monedhë ose blerja e mallrave janë në përputhje me këtë përkufizim. Gjithashtu, edhe një transaksion jo financiar, si: lëvizja apo dorëzimi i parave nga një person tek një tjetër janë në përputhje me përkufi zimin.
- Pasuria buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal
- Kryerësi është në dijeni se pasuria buron nga ndonjë formë e aktivitetit kriminal
- Ekzistimi i dashjes
- Konvertimi apo transferimi bëhet me qëllim të fshehjes së origjinës së pasurisë

³¹ Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i Republikës së Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i RKS, Prishtinë, 2016, neni 56

Sipas raportit të Këshillit Prokurorial të Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2014 janë trajtuar 42 lëndë nga fusha e shpërlarjes së parave, ku 14 lëndë (33% e numrit të lëndëve) janë zgjidhur brenda vitit. Ndërsa gjatë viti 2015 janë trajtuar 36 lëndë lidhur me pastrimin e parave, ku vetëm 6 prej tyre janë zgjidhur (gjithsej 17% e numrit të lëndëve) ndërsa 30 lëndë të tjera kanë ngelur të pazgjidhura.³²

Tabela I: Numri i lëndëve të trajtura nga Prokuroria Speciale lidhur me shpërlarjen e parave

	Nr i lëndëve të zgjidhura	Përqindja e lëndëve të zgjidhura	Nr i lëndëve të pazgjidhura	Përqindja e lëndëve të pazgjidhura
2014	14	33%	28	67%
2015	6	17%	30	83%

Nga tabela mësipër vërejmë së numri i rasteve të zgjidhura të veprave të shpërlarjes së parave është i ulët. Si arsye për këto rezultate jo të mira mund të jenë së pari mungesa e gjyqtarëve dhe prokuroreve të specializuar në fushën e shpërlarjes së parave dhe së dyti kompleksiteti i zbulimit dhe hetimit të shpërlarjes së parave.

2. Shmangia nga tatimi si formë e kriminalitetit ekonomik

Mbledhja e taksave dhe tatimeve është njëra nga veprimtaritë më të rëndësishme të shtetit, ngase prej tyre formohet pjesa më e madhe e buxhetit shtetëror. Shmangia nga tatimi shkakton pasoja të rënda për shoqërinë, ndër të cilat vecohen:

- Krijimi i pabarazisë në botën e biznesit
- Krijon para të tepërta dhe të lira për tu përdorur pa kriter, për tu përdorur në favor të korrupsionit të nënpunësve shtetërorë ose për të kryer financime të paligjshme.

³² Kipred, Reagimi ndaj Pastrimit të parave në Kosovë, në mes të politikës dhe praktikave, Prishtinë, 2016

- Krijon mundësinë e ardhjes së pasojave të rënda sociale ngaqë mban të mberthyer në pasiguri për punën dhe ardhmërinë e tyre të gjithë punjonësit e një biznesi të tillë të paligjshëm.³³

Në Kodin penal të Republikës së Kosovës, vepra penale e Shmangies nga tatimi është paraparë në nenin 313, ku ceket se *“Kushdo që me qëllim që ai apo personi tjetër të fsheh apo të shmangët, pjesërisht apo tërësisht, pagesën së tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, jep të dhëna të pavërteta apo nuk i përfshin të dhënat lidhur me të ardhurat e tij, pasurisë, gjendjen ekonomike apo fakte të tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve të tilla, denohet me gjobë ose burgim deri në tri vite”*. Forma të kualifikuara të kësaj vepra janë shmangiet tatimore që kalojnë shumën prej 15.000 Euro që denohen me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet, si dhe shmangiet tatimore që tejkalojnë shumën prej 50.000 Euro, që dënohen me burgim prej një deri në tetë vite.³⁴

Veprimet me të cilat kryhet kjo vepër penale janë paraparë në mënyrë alternative si vijon:

- a) Duke dhënë të dhëna të pavërteta për të ardhurat e veta me qëllim që t'i shmangët pjesërisht apo tërësisht pagimit të tatimit, tarifave apo kontributeve të përcaktuara me ligj dhe
- b) Duke mos përfshi informatat lidhur me të ardhurat e tij, gjendjen ekonomike apo fakte tjera relevante për vlerësimin e detyrimeve, me qëllim që t'i shmangët pjesërisht apo tërësisht pagimit të tatimit, tarifave apo kontributeve të përcaktuara me ligj.

Me rastin e dhënies së shënimeve (të dhënat) të pavërteta, më shpesh kemi të bëjmë me paraqitjen e të ardhurave (të hyrave) më të ulëta apo paraqitjen e shpenzimeve më të mëdha nga ato të vërtetat, shënime për pasurinë e cila i nënshtrohet tatimit, numrit të punësuarve për të cilët duhet paguar kontributet e të ngjashme. Vepra, parimisht, kryhet me paraqitjen e librave afariste me shënime të pavërteta personelit të organit tatimor apo me rastin e plotësimin të fletëparaqitjeve tatimore me shënime të pavërteta dhe dorëzimi i tyre tek organi tatimor.

Forma e dytë e kësaj vepre penale kryhet me mos përfshirjen e informatave lidhur me të

³³ Arben Rakipi, *Korrupsioni dhe Evazioni Fiskal*, Tiranë, 2003, fq 123-125

³⁴ Kodi penal i Republikës së Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i RKS, Prishtinë, 2013, neni 313

ardhurat e tij, gjendjen ekonomike apo fakte të tjera relevante për vlerësimin detyrimeve të këtilla, p.sh.janë rastet kur fletëparaqitja tatimore nuk i përfshin informatat lidhur me të hyrat, gjendjen ekonomike apo faktet tjera të nevojshme për përcaktimin e lartësisë së tatimit edhe pse është detyrim ligjor apo kur nëparaqitjen tatimore nuk tregohen shënimet mbi faktet të cilat kanë të bëjnë me bazën themelore për vlerësimin e lartësisë së tatimit ose të caktimit të kontributeve.³⁵

Për të ju shmangur pageses së tatimit, subjektet ekonomike përdorin forma të ndryshme për të realizuar qellimet e tyre:

- 1) Tregtarët të cilët duhet të paguajnë tatim nuk regjistrohen në organe tatimore dhe për pasojë shteti nuk përfiton pjesën e përcaktuar me ligj që duhet të kalojë atij për shkak të aktivitetit ekonomik që ushtron subjekti i peregjistruar.
- 2) Mosdeklarimi i të ardhurave personale, ku individët punojnë duke u paguar në cash në dore nga punëdhënësi pa deklaruar të ardhurat e tyre. Kjo formë e shmangies nga tatimi ka pasojë të rënda sociale për punëtorin i cili në të ardhmen nuk do të mund të realizojë të drejtat e tij të sigurimit social.
- 3) Nxjerrja në humbje e aktivitetit biznesor, ku mekanizmi i përdorur në këto rast është rritja fikitive e shpenzimeve të ndryshme. Në shpenzimet e nevojshme pasqyrohen si të kryera disa herë më tepër ato për lëndën e parë, konsulencat e ndryshme, pagesat për ujë, drita, qerata e objekteve, mjeteve, studimeve për fisibilitetin e aktivitetit apo zgjerimeve të mundshme etj. Një tjetër mekanizëm i përdorur për të arritur të njëjtin përfundim është edhe mosfaturimi i të gjitha shitjeve që subjekti ka kryer dhe në këtë rast të ardhurat paraqiten si më të vogla ndërsa shpenzimet janë regjistruara të rritura.
- 4) Mosdeklarimi i nënkontraktorëve, ku shpesh subjekte të mëdha lidhin marrëdhënie nënkontraktore me subjekte më të vegjël, për të përmbushur detyra në sasi më të vogël. Kështu më shpesh veprojnë subjektet e mëdha ndërtimore, të cilët për punime të brendshme të objektit përdorin grupe të vogla të elektrikistëve, hidraulikëve ose njësi të tjera ndihmëse që nuk janë të regjistruara dhe nuk figurojnë si subjekte të

³⁵ Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, Komentari i Kodit penal të Republikës së Kosovës, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq 864

tatueshme.Punime e tyre regjistrohen si te kryera nga subjekti i madh, ndërsa subjektet e nënkontraktuara i shpëtojnë pagimit të detyrimeve.

- 5) Shitjet me para në dorë (Cash) dhe jo nëpërmjet sistemit bankar janë ndër format e shmangies nga tatimi.Duke mos patur mundësi kontrolli të transaksionit financiar nga organet tatimore, shitësi mund të mos e regjistrojë edhe tërë veprimtarinë e tyre në librat e llogarisë.Poashtu edhe blerësit duke mos regjistruar transaksionin si blerje, i krijojnë mundësi atij pas një blerje të tillë të deklarojë më pak shitje.
- 6) Kërkesa për rimbursim të pamerruar apo kërkeses për kreditim të TVSH së paguar në blerje, është një mekanizëm që përdoret shpesh për të shmangur pagesën e tatimit.Kjo metodë shoqërohet me prodhimin e faturave fiktive për të simuluar blerje që në fakt nuk janë bërë.Në këtë rast, prej subjektit të tatueshëm, mund të krijohen një numër i madh faturash fiktive që rezultojnë si të prejardhura nga marrëdhënie biznesore të tij me të tretët, ku ai është paraqitur si blerës.Në këtë rast blerësi, sasinë e tatimit shprehur në para të paguara në blerje, mund ta kreditojë në favor të tij gjatë shitjes së mallit.
- 7) Blerjet në cash të paregjistruara, ku tregtarët blejnë mallra nga një furnizues kryesor i paregjistruar në tatime dhe për arsye se transaksioni nuk është regjistruar prej shitësit, si në rastin e përshkruar më lart, blerësi është në gjendje të shesë këto mallra pa ngarkuar vlerën e TVSH dhe kjo marrëdhënie nuk do të regjistrohet.
- 8) Shitjet e deklaruara poshtë vlerës së tyre reale është mënyra më e zakonshme për të shmangur TVSH.Vlera më e ulët e shitjeve, pakëson TVSH e administruar nga administrata tatimore.
- 9) Kërkesa e kreditimit fallso të eksportit është një tjetër mekanizëm i shmangies nga tatimi.Kompanitë që eksportojnë produktet e tyre shpesh kërkojnë një kreditim të vazhdueshëm nga qeveria.Në rastet e shitjeve fiktive nga eksporti, mund të jenë bërë fatura të tilla justifikuese dhe më pas bëhet kërkesa për rimbursim të TVSH nga shteti.
- 10) Këmbimi mall me mall është një nga mekanizmat më të thjeshtë për të shmangur tatimit.Nëse ka marrëveshje midis blerësit dhe shitësit për të shkëmbyer mallrat dhe shërbimet pa pagesë dhe fatura, atëherë detyrimet mund të mos dokumentohen për

pagimin në TVSH.Ky mekanizëm kryesisht përdoret nga tregtarët e vegjël, për shkëmbime të vogla, ndërmjet të cilëve ka një frekuencë të vazhdueshme shkëmbimeve të tilla tregtare.³⁶

Në vitin 2014, lidhur me vepren penale Shmangie nga tatimi janë dënuar 39 persona nga ta, 35 meshkuj dhe 4 femra.Nga ta 18 kryerës janë dënuar me gjobë, 8 kryerës janë dënuar me dënim më pak se një vit, dhe 13 kryerësve i u është shqiptuar dënim me kusht.³⁷

Në vitin 2015, lidhur me këtë vepër janë dënuar 27 persona, nga të cilët 26 meshkuj dhe 1 femër.Nga ta 12 kryerës janë dënuar me gjobe, një kryerës është dënuar me dënim më pak se një vit, ndërsa 14 kryerësve i u është shqiptuar dënimi me kusht.³⁸

Në vitin 2016, janë dënuar 14 persona për shmangie nga tatimi, të cilët të gjithë i përkisnin gjinisë mashkullore.Prej të dënuarve, tre kryerësve u shqiptua dënim me gjobë, dy kryerësve u shqiptua dënim me burg më pak se një vit, dhe 9 kryerësve u është shqiptuar dënim me kusht.³⁹

Në vitin 2017, janë dënuar 18 persona për shmangie nga tatimi, nga ta 17 meshkuj dhe një femër.Nga ta, 4 kryerës morrën dënim me gjobë dhe 14 kryerësve u është shqiptuar dënimi me kusht.⁴⁰

³⁶ Arben Rakipi, vep e cituar,Tiranë, 2003, fq 127-142

³⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e jurisprudences për persona madhor 2014

³⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e jurisprudences për persona madhor 2015

³⁹ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e jurisprudences për persona madhor 2016

⁴⁰ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e jurisprudences për persona madhor 2017

Tabela II: Numri i personave të dënuar për vepren penale shmangia nga tatimi

	Nr i Kryerësve	Gjinia		Dënimet							
		Meshkuj	Femra	Gjorbë	< 1 vit	1-2 vite	2-5 vite	5-10 vite	10 vite>	Dënim me kusht	Vërejte
2014	39	35	4	18	8	/	/	/	/	13	/
2015	27	26	1	12	1	/	/	/	/	14	/
2016	14	14	/	3	2	/	/	/	/	9	/
2017	18	17	1	4	/	/	/	/	/	14	/

Nga tabela e mësipërme mund të vërejmë se kemi një rënie të vepres penale te shmangies nga tatimi në vitet 2016 dhe 2017 në krahasim me vitet 2014 dhe 2015. Numri më i lartë i kësaj vepre paraqitet në vitin 2014 ndërsa numru më i ulët në vitin 2016. Sa i përket kryerësve dominon dukshëm gjinia mashkullore në krahasim me gjininë femërore. Ndërsa sa u përket dënimeve, kryesisht janë shqiptuar dënime me gjobë dhe dënime me kusht, e më pak dënime me burgim.

3. Falsifikimi i parasë si formë e kriminalitetit ekonomik

Falsifikimi i parave, sidomos i bankënotave dhe apoenave në letër, është dukuri kriminale shumë e përhapur e kriminalitetit të organizuar ekonomik në botën bashkëkohore. Falsifikimi i parave u sjell përfitime të mëdha organizatorëve dhe kryerësve të këtij aktiviteti kriminal. Zakonisht falsifikohen paratë e shteteve me valuta të forta, si dollari amerikan, euro dhe valuta tjera të sigurta, të cilat gëzojnë renome në tregun e parave por edhe ngase këto valuta janë më shumë në qarkullim dhe më pak dyshohet në kualitetin e tyre.⁴¹ Prodhimi i parasë së rrejshme apo ndryshimi i parasë së vërtetë dhe vënia në qarkullim si para e vërtetë, paraqet rrezik dhe dëm të madh për ekonominë e vendit dhe të vendeve tjera, andaj është inkriminuar në të gjitha legjislacionet penale të shteteve dhe ka karakter ndërkombëtar. Në këtë drejtim është aprovuar edhe Konventa ndërkombëtare për luftimin e prodhimit të parasë së rrejshme. Vlen të përmendet Konventa e Gjenevës mbi paranë.

Sipas Departamentit të Thesarit të ShBA-ve aktualisht në qarkullim janë rreth 70 milion dollarë të falsifikuar. Motivi më i shpeshtë i kryerjes së falsifikimeve është lakmia për të holla, dëshira të fitojë vend pune më të mirë, fshehja e veprave tjera penale, urrejtja dhe hakmarrja, dëshira që të përparojë në vendin e punës, për të prokuruar substanca narkotike, ndërsa janë të rralla motivet politike dhe patologjike.⁴²

Në nenin 302 të Kodit penal të Republikës së Kosovës është paraparë vepra penale e *Falsifikimit të parasë* si në vijim:

1. *Kushdo që prodhon para të falsifikuara me qëllim për t'i vendë në qarkullim si të vërteta, dënohet me burgim prej një deri në dhjetë vjet.*
2. *Kushdo që duke ditur se paraja është e falsifikuar merr, vë në qarkullim, transporton, pranon, përdorë ose posedon paranë të falsifikuar me qëllim që ta vë në qarkullim si të vërtetë, dënohet me burgim prej një deri në tetë vite.*

⁴¹ Ragip Halili, vep e cituar, Prishtinë, 2016, fq 153

⁴² Vesel Latifi, Kriminialistika, Prishtinë, 2012, fq 419

3. *Kushdo që pranon paranë e falsifikuar prej pesëdhjetë Euro ose më pak duke besuar se është e vertetë dhe pastaj e përdorë duke dituar se është e falsifikuar, denohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.*
4. *Kushdo që ka dijëni për prodhimin apo përdorimin e parave të falsifikuara dhe këtë nuk e raporton, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.*
5. *Kur vepra penale nga paragrafi 1. dhe 2. I këtij neni ka të bëjë me një shumë të parave të falsifikuara që tejkalon njëqindmijë Euro, kryerësi dënohet me jo më pak se tre vjet burgim.*
6. *Paraja e falsifikuar dhe pajisjet për prodhimin apo ndryshimin e saj konfiskohen⁴³*

Veprimet me të cilat kryhet vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni janë: a) prodhimi, b) ndryshimi ose c) vënia e parasë së falsifikuar në qarkullim. Me prodhim nënkuptojmë prodhimin e mjetit apo sendit i cili në çdo mënyrë e imiton (i ngjanë) paranë e vërtetë. Paraja duhet të prodhohet (mbarohet) ashtu që në shikimin e parë nuk mund të dallohet se nuk është para e vërtetë. Duhet t'i përngjaj parasë së vërtetë ashtu që nuk mundet, kryesisht, të dallohet (ashtu quajtur imitatio vera). Nuk ka vepër penale nëse prodhimi i parasë së rreme apo paraja e ndryshuar është aq e dobët sa që lehtë mund të vërehen karakteristikat e saja.

Ndryshimi i parasë së vërtetë do të thotë, ndërrimi i natyrës, pamjes dhe i përmbajtjes. Ndryshimi, kryesisht, ka të bëjë me ndërrimin e vlerës së saj, sepse pa te nuk ka ndryshim. Ndryshimi duhet të jetë ashtu që në shikimin e parë nuk mund të vërehet çfarë do ndërrimi në paranë e vërtetë. Vepra penale do të konsiderohet si e kryer me vetë faktin e ndryshimit me qëllim që të vihet në qarkullim si para me vlerë më të madhe. Për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni është e rëndësishme se paraja nëfjalë nuk është jashtë përdorimit pa marrë parasysh se për cilën valutë është fjala.

Veprimet me të cilat kryhet vepra penale nga paragrafi 2 i këtij neni janë paraqitë në mënyrë alternative dhe atë: a) duke marr (furnizohet); b) vënia në qarkullim paranë e falsifikuar; c) transportimi i parasë së falsifikuar; d) përdorimi i parasë së falsifikuar dhe f) me posedimin e parasë së falsifikuar me qëllim që të vihet në qarkullim si e vërtetë. Marrja (furnizimi) mund të

⁴³ Kodi penal i Republikës së Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i RKS, Prishtinë, 2013, neni 302

bëhet me blerje, mbledhje, me shkëmbim, me vjedhje etj. Nuk është e rëndësishme se si kryerësi i kësaj forme të veprës penale furnizohet apo vihet në posedim të parasë së falsifikuar. Po të mos ekzistojë qëllimi për ta vënë në qarkullim parane e falsifikuar, atëherë vepra penale nuk do të ekzistojë. Vënia e parasë së falsifikuar në qarkullim, realizohet kur ajo përdoret, kur mundësohet përdorimi i mëtejshëm e që më së shpeshti realizohet kur i dorëzohet personit tjetër, p.sh. kur bëhet pagesa e mallit apo shërbimit, shlyerja e borxhit, kur jepet si hua, kur jepet për shkëmbim dhe të ngjashme.⁴⁴

Në vitin 2014, lidhur me veprën penale Falsifikimi i parave, janë dënuar 41 persona, 37 meshkuj dhe 4 femra. Prej tyre, 14 kryesve i është dhënë dënimi me gjobë, 6 kryesve dënim me burgim deri në një vit, një kryerësi dënim deri në dy vite, një kryerësi të kësaj vepre i është shqiptuar dënim mbi dhjetë vite. Poashtu gjatë këtij viti janë shqiptuar 17 dënime me kusht dhe një vërejtje gjyqësore.⁴⁵

Në vitin 2015, lidhur me veprën në fjalë, janë dënuar 16 persona, 15 meshkuj dhe një femër. Poashtu gjatë këtij viti, 7 persona janë dënuar si bashkëkryerës në këtë veprë penale. Prej tyre, 6 të dënuarve i u është dhënë dënim me gjobë, 2 kryerës janë dënuar me burgim deri në një vit, një kryerës është dënuar deri në 2 vite, janë shqiptuar 6 dënime me kusht dhe një vërejtje gjyqësore.⁴⁶

Në vitin 2016, kemi 21 persona të dënuar, 20 meshkuj dhe një femër. Prej tyre, 5 të dënuar me gjobë, 5 të dënuar me burgim deri në një vit, dhe 11 të dënuar me kusht.⁴⁷

Në vitin 2017, kemi 34 persona të dënuar për falsifikim parash, ku nga ta 28 janë meshkuj dhe 6 femra. Gjatë këtij viti 15 persona janë dënuar si bashkëkryerës të kësaj vepre penale, prej të cilëve 14 meshkuj dhe një femër. Nga ta, 6 janë dënuar me gjobë, 10 me burgim deri në 1 vit, 1 kryerës i kësaj vepre është dënuar mbi 10 vite, dhe 17 të tjerë të dënuar me kusht.⁴⁸

⁴⁴ Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, Komentari i Kodit penal të Republikës së Kosovës, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq 838-839

⁴⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e jurisprudencës për persona madhor 2014

⁴⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e jurisprudencës për persona madhor 2015

⁴⁷ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e jurisprudencës për persona madhor 2016

⁴⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e jurisprudencës për persona madhor 2018

Tabela III: Numri i personave të dënuar për veprën penale “Falsifikimi i parave”

	Nr i Kryerësve	Gjinia		Dënimet							
		Meshkuj	Femra	Gjohë	< 1 vit	1-2 vite	2-5 vite	5-10 vite	10 vite>	dënim me kusht	Vërejte
2014	41	37	4	14	6	1	1	/	1	17	1
2015	16	15	1	6	2	1	/	/	/	6	1
2016	21	20	1	5	5	/	/	/	/	11	/
2017	34	28	6	6	10	/	/	/	1	17	/

Nga tabela e mësipërme mund të vërejmë se gjatë vitit 2015 kemi pasur një rënie të theksuar të vepres së falsifikimit të parasë, mirëpo gjatë viteve 2016 dhe 2017 na paraqitet përsëri një ngritje graduale e kësaj veprë. Numri më i lartë i kësaj veprë paraqitet në vitin 2014 ndërsa numri më i ulët në vitin 2015. Gjinia mashkullore është dominuese si kryerëse e kësaj veprë në krahasim me gjinin femerore. Sa u përket dënimeve, kryesisht janë shqiptuar dënim me gjobe, dënim me kusht dhe dënim me burgim deri në 1 vit, me përjashtim të viteve 2014 dhe 2017 ku nga një rast është shqiptuar dënim më i rëndë me mbi 10 vite.

4. Mashtrimi i konsumatorëve si formë e kriminalitetit ekonomik

Mashtrimi i konsumatorëve paraqet një ndër format shumë të shprehura të kriminalitetit ekonomik. Ky lloj kriminaliteti kryhet në të gjitha vendet e botës. Format më të shpeshta të kriminit të mashtrimit të konsumatorëve kanë të bëjnë me kualitetin e artikujve ushqimorë,

përmbajtjen dhe cilësinë e tyre, në distribuimin e barnave dhe medikamenteve të rrezikshme të cilave u ka kaluar koha, prodhimi i artikujve me pesticide dhe materie kancerogjene, dhënia e kredive të ndryshme me kushte jo të favorshme, shitja e mallrave dhe artikujve pa garanci, moskryerja e shërbimeve në nivel dhe me cilësi, në amvisëri, shitja e makinave dhe automobilëve të ndryshëm me të meta dhe gabime teknike dhe shumë aktivitete të ngjajshme.⁴⁹

Kodi penal i Republikës së Kosovës në nenin 298 ka parashikuar veprën penale “*Mashtrimi me konsumator*” si në vijim: *Kushdo që gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike dhe me qëllim të mashtrimit të blerësve apo konsumatorëve, përdor ose posedon me qëllim të përdorimit si emer apo shenjë të tij ose shenjë të vecantë të mallrave të tij, emrin apo shenjën e tjetrit, shenjën e mallrave apo shërbimeve të tjetrit, ose shenjën e tjetrit që lidhet me prejardhjen gjeografike ose ndonjë shenjë tjetër të vecantë të mallrave apo përbërësve të tyre, dënohet me burgim deri në tri vjet.*⁵⁰

Veprimi me të cilin kryhet vepra penale nga paragrafi 1.i këtij neni është përdorimi ose posedimi me qëllim të përdorimit të emrit të huaj, shenjës së huaj, shenjën e mallit apo shenjën e shërbimit të huaj apo shenjën e huaj lidhur me prejardhjen gjeografike a shenjat tjera të mallit apo pjesëve të tij në firmën (emrin) e vet, në shenjën e vet apo në shenjat e veta të posaçme të mallit gjatë ushtrimit të veprimtarisë ekonomike me qëllim të mashtrimit të blerësit apo konsumatorit. Sipas përkufizimit të kësaj vepre penale nga paragrafi 1, konsiderohet e kryer vetëm nëse veprimet e kryerjes janë ndërmarrë me qëllim të mashtrimit të blerësve apo të konsumatorëve.⁵¹

Ndërsa në nenin 299 është parashikuar vepra penale “*Mashtrim me blerës*” ashtu që: *Kushdo që me qëllim të mashtrimit të blerësve vë në qarkullim prodhime me shnjën në të cilën janë shënuar të dhëna të cilat nuk i përgjigjen përmbajtjes, llojit, prejardhjes apo kualitetit të produktit, vë në qarkullim produkte të cilat për nga pesha apo kualiteti nuk i përgjigjen asaj që rregullisht parashihet të produktet e tilla apo vë në qarkullim produkte pa shenjat që tregojne*

⁴⁹ Ragip Halili, vep e cituar, Prishtinë, 2016, fq 202-203

⁵⁰ Kodi penal i Republikës së Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i RKS, Prishtinë, 2013, neni 298

⁵¹ Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, Komentari i Kodit penal të Republikës së Kosovës, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq 827

*për përmbajtjen, llojin, prejardhjen apo kualitetin e produktit kur shenja e tillë kërkohet me ligj, dënohet me gjobe ose me burgim deri në tri vite.*⁵²

Veprimet me të cilat kryhet vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni janë të parapara në mënyrë alternative dhe atë: a) me vënien në qarkullim të prodhimeve me shenjen në të cilën janë shënuar të dhëna të cilat nuk u përgjigjen përmbajtjes, llojit, prejardhjes apo kualitetit të produktit; b) vënia në qarkullim produkte të cilat për nga pesha ose kualiteti nuk i përgjigjen asaj që rregullisht parashihet te produktet e tilla dhe c) vënia në qarkullim i produkteve pa shenja që tregojnë përmbajtjen, llojin, prejardhjen apo kualitetin e produktit kur shenja e tillë kërkohet me ligj. Veprimet me të cilat kryhet vepra penale nga paragrafi 2 janë paraparë në mënyrë alternative si vijon: a) duke shpall rrejshëm se është zbrit çmimi i mallit; b) duke shpallë rrejshëm se pritët rritja e çmimeve, dhe c) në ndonjë mënyrë tjetër bën haptas reklamë të rreme.⁵³

Në vitin 2015, për vepren penale mashtrimi i konsumatorëve, janë dënuar 4 persona, 3 meshkuj, një femër. Prej tyre, një kryerës u dënua me gjobë ndërsa 3 me dënim me kusht. Ndërsa sa i përket vepres penale, mashtrim me blerës, është dënuar vetëm një person i gjinisë mashkull, i cili për vepren e kryer u dënua me gjobë.⁵⁴

Në vitin 2016, për mashtrim me konsumator janë dënuar 2 persona si kryerës kryesor dhe 2 si bashkëkryerës. Nga ta, një kryerës u dënua me burgim deri në dy vite, një me dënim me kusht, dhe poashtu bashkëkryerësit u është shqiptuar dënimi me kusht. Ndërsa për mashtrim me blerës janë dënuar gjithsej 3 persona, ku 2 u dënuan me gjobë dhe një me kusht.⁵⁵

Në vitin 2017, gjithsej të dënuar për mashtrim me konsumator ishin 3 persona, dy me dënim me gjobë, një me dënim me kusht. Ndërsa për mashtrim me blerës vetëm një person, të cilit i u shqiptua dënimi me kusht.⁵⁶

⁵² Kodi penal i Republikës së Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i RKS, Prishtinë, 2013, neni 299

⁵³ Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, Komentari i Kodit penal të Republikës së Kosovës, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq 829

⁵⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e jurisprudences për persona madhor 2015

⁵⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e jurisprudences për persona madhor 2016

⁵⁶ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e jurisprudences për persona madhor 2017

Tabela IV: Numri i personave të dënuar për vepren penale “Mashttrim me konsumatorë”

	Nr i Kryerësuv	Gjinia		Dënimet							
		Meshkuj	Femra	Gjorbë	< 1 vit	1-2 vite	2-5 vite	5-10 vite	10 vite>	Dënim me kusht	Vërejte
2014	/	/	/	/	/	/	/	/	/		/
2015	4	3	1	1	/	/	/	/	/	3	/
2016	2	2	/	/	/	1	/	/	/	1	/
2017	3	3	/	2	/	/	/	/	/	1	/

Nga tabela e mësipërme vërejmë një numër më të ulët të kësaj vepre në krahasim me veprat tjera nga fusha e kriminalitetit ekonomik. Në vitin 2014 nuk paraqitet asnjë rast nga kjo vepër, ndërsa gjatë viteve në vijim kemi një numer të ulët të paraqitjes së kësaj vepre. Si dënim më i shqiptuar për këtë vepër është dënimi me gjobë dhe dënimi më kusht.

Tabela V: Numri i personave të dënuar për veprën penale “Mashtrim me blerës”

	Nr i Krverësuv	Gjinia		Dënimet							
		Meshkuj	Femra	Gjobë	< 1 vit	1-2 vite	2-5 vite	5-10 vite	10 vite>	Dënim me kusht	Vërejte
2014	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/	/
2015	1	1	/	1	/	/	/	/	/	/	/
2016	3	2	1	2	/	/	/	/	/	1	/
2017	1	/	1	/	/	/	/	/	/	1	/

Poashtu edhe vepra e mashtrimit me blerës karakterizohet me një numër të ulët të personave të dënuar. Vetëm në vitin 2016 kemi 3 persona të dënuar, në krahasim me vitet tjera, 2015 dhe 2017, ku kemi nga një person të dënuar, ndërsa në vitin 2014 nuk kemi ndonjë rast të mashtrimit me blerës.

5. Korrupsioni si formë e kriminalitetit ekonomik

Nocioni “korrupsion” buron nga fjala latine “*coorumpere*”, që do të thotë prishje, mitosje, blerje, korrupsion. Lidhur me fenomenin e korrupsionit ka mendime dhe përkufizime të ndryshme që dallojnë varësisht nga koha dhe rrethanat politike dhe shoqërore.

Korrupsioni është dukuri patologjike, shtrembërim sistemor në të cilin klasa politike në pushtet

vë interesin personal mbi interesat politike të bashkësisë.⁵⁷Korrupsioni nuk është temë e re. Ai vështrohet si një kërcënim i hapur për shoqërinë, ekonominë, administratën dhe rregullimin shoqëror që më shumë se një mijë vjet. Në vitin 3.200 para Krishtit, Hamurabi i Babilonisë ishte bërë i njohur për shkak se e kishte urdhëruar guvernatorin e provincës që të shqyrtojë akuzat për korrupsion. Pas rezultateve të hetimeve ka dënuar me vdekje disa zyrtarë të korruptuar. Para 3.000 vjetësh, mbreti Manu i Indisë, ka vendosur rregulla për konfiskimin e pasurisë së fituar me korrupsion. Në papiruset e Egjiptit, të cilat i takojnë periudhës para erës së Krishtit, është shkruar për korrupsionin e ndërtuesve dhe të afërmeve të faraonëve. Në Greqinë e vjetër, korrupsioni ka qenë një prej çështjeve qendrore të shtetit, sidomos në shekujt V dhe VI para Krishtit.⁵⁸

Konventa e Kombeve të bashkuara kundër krimit të organizuar trans-nacional, përmban dispozita juridike, me qëllim të luftimit të korrupsionit. Në nenin 8 të kësaj konvente është parashikuar që “Cdo shtet anëtar merr përsipër obligimin që të sanksionojë të dënueshme veprat e mëposhtme:

- a) Premtimin, ofrimin ose dhenien, direkte ose indirekte, të interesit në menyrë jo të rregullt, personalisht zyrtarit publik ose ndonjë personi tjetër fizik apo juridik, me qëllim që zyrtarit publik të veprojë ose të mos veprojë për kryerjen e detyrës së tij zyrtare.
- b) Nxitja pse pranimi, direkt ose indirekt, i interesit të kunderligjshëm nga zyrtari publik, për të apo ndonjë person tjetër ose juridik, në menyrë që ai zyrtar të veprojë ose të mos veprojë për kryerjen e detyrës së tij zyrtare”⁵⁹

Keshilli i Europës, në raportin e paraqitur në mbledhjen e vitit 1994, ka caktuar të ashtuquajturin definicion pune për korrupsionin.”Keqpërdorimi i pozites publike, shoqërore ose ekonomike, gjegjësisht shfrytëzimi i ndikimit real apo të supozuar në bazë të kesaj pozite, me qëllim që në mënyre të kunderligjshme, për vete ose për dikë tjetër, të sigurohet ndonjë fitim material apo ndonjë përparësi politike ose ekonomike.⁶⁰

⁵⁷ Dr Veton Vula, vep e cituar, Prishtinë, 2012, fq 209

⁵⁸ Dr Mersida Sucecka, vep e cituar, Prishtinë, 2006, fq 132

⁵⁹ Konventa e Kombeve të bashkuara kundër krimit të organizuar trans-nacional, e miratuar nga Asambleja e OKB, 2000

⁶⁰ Konventa evropiane kundër korrupsionit, e miratuar në Strasburg nga Këshilli i Evropës, 1999

Dallohen dy lloje kryesore të korrupsionit, të cilat janë 1) korrupsioni në sektorin publik dhe 2) korrupsioni në sektorin privat. Korrupsioni në sektorin publik përfshin: -korrupsionin administrativ që kryhet brenda administratës lokale dhe qendrore, autoritetet e doganës, kujdesin shëndetsor dhe asistencën sociale, kulturën dhe arsimin, mbrojtjen, rendin publik dhe institucionet e sigurisë kombëtare, -korrupsionin gjyqësor që lidhet me autoritetet gjyqësore dhe prokuroriale, -korrupsioni ekonomik që përfshin në veçanti sistemin financiar-bankar, -korrupsioni politik që kryesisht ndikon në aktivitetin parlamentar dhe partitë politike. Korrupsioni në sektorin privat përfshin operacionet tregtare të kryera nga shoqëritë tregtare vendore dhe ndërkombëtare. Ai ndërhyr në konkurrencën e drejtë dhe rregullat e ekonomisë të tregut të lirë, redukton cilësinë e produkteve dhe shërbimeve dhe minon investimet ekonomike. Krimet e korrupsionit shpesh përfshijnë zyrtarët të cilët korruptohen në shkëmbim të dhënies së lehtësirave fiskale ose kontratave të caktuara shoqërive të caktuara. Kjo mund të shkojë nga kontratat e prokurorimit në shkallë të vogël deri në koncesionet për prodhimin e armëve dhe koncesioneve për burimet natyrore.

Po ashtu duhet të bëhet dallimi edhe ndërmjet korrupsionit aktiv dhe korrupsionit pasiv. Korrupsioni aktiv konsiston në ofrimin ose premtimin e përfitimeve një vendimarrësi (dhënie mito, tregti influence), ndërsa korrupsioni pasiv konsiston në pranimin e ketyre përfitimeve (marrje mito, marrje e përfitimeve të padrejta, tregtim influence)⁶¹

Ndonëse veprat e korrupsionit në kodin penal parashikohen vecmas prej veprave nga fusha e ekonomisë, prap është e vështirë që këto dy kategori të kriminalitetit të trajtohen ndaras ngase mes tyre ekziston një lidhshmëri e madhe. Korrupsioni si formë e kriminalitetit përmban karakteristika të ngjashme me format e tjera të kriminalitetit ekonomik, si nga ana objektive edhe subjektive. Veprimet korruptive dëmtojnë zhvillimin normal të ekonomisë, demokracisë, funksioneve publike, pengon konkurrencen dhe funksionimin e shtetit ligjor. Sikurse tek krimet tjera ekonomike edhe tek korrupsioni, kryerësi posedon cilësi të dallueshme nga personat e zakonshëm. Ata në të shumtën e rasteve janë njerëz të ngarkuar me funksione publike dhe pushtet, me shkallë të lartë të arsimimit dhe të ardhurave. Qëllimi primar i korrupsionit është interesi ekonomik-financiar, mirepo nuk kufizohet vetëm me interesa të tilla. Në shumë rast,

⁶¹ Cristi Danilet, Korrupsioni dhe antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë, Tiranë, 2011 fq 62-63

qëllimi i kryerjes se veprimeve korruptive nuk është interesi financiar mirëpo interesa të tjera si pushteti politik apo favore të mëvonshme.

Në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, veprat penale nga fusha e korrupsionit janë parashikuar në kapitullin XXXIV, nenet 422-437. Si vepra të korrupsionit janë paraparë: *Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar (neni 422), Keqpërdorimi i informatës zyrtare (423), Konflikti i interesit (424), Përvetësimi në detyrë (425), Mashtrimi në detyrë (426), Përdorimi i paaturrozuar i pasurisë (427), Marrja e ryshfetit (428), Dhënia e ryshfetit (429), Dhënia e ryshfetit zyrtarit publik të huaj (430), Ushtrimi i ndikimit (431), Nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore (432), Zbulimi i fshehtësisë zyrtare (433), Falsifikimi i dokumentit zyrtar (434), Arkëtimi dhe pagesa e kundërligjshme (435), Përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë me rastin e bastisjes apo ekzekutimit të vendimit gjyqësor (436), Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare (437)*⁶²

Vepra penale e “Keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar është paraparë në atë menyrë që cdo person zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që ti shkaktojë dëm personit tjetër ose serizisht ti shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Veprimi i kryerjes se kësaj vepre penale konsiston në a)keqpërdorimin e detyrës zyrtare b)tejkalimin e autorizimeve c)mos kryerja e detyrave zyrtare. Kryerës i kësaj vepre mund të jetë vetëm personi zyrtar.⁶³

Gjatë vitit 2014, për Keqpërdorim të detyrës zyrtare janë dënuar 33 persona, nga ta 10 të dënuar me gjobë, 3 me dënim me burgim deri në një vit, dhe 20 të dënuar me kusht.

Gjatë vitit 2015, për këtë vepër gjithsej janë 31 të dënuar, 9 nga ta të dënuar me gjobë, 7 të dënuar me burgim deri në një vit, një i dënuar deri në 2 vite, dhe 14 të dënuar me kusht.

Në vitin 2016 gjykatat kanë gjetur fajtor për këtë veper 38 persona, 6 janë dënuar me gjobë, 7 me burgim deri në një vit, një me burgim deri në 2 vite, një me burgim deri në 5 vite dhe 23 të tjerë janë dënuar me kusht.

⁶² Kodi penal i Republikës së Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i RKS, Prishtinë, 2013, nenet 422-437

⁶³ Ismail Zejneli, E drejta penale-pjesa e posacme, Tetove, 2007, fq 151

Në vitin 2017, gjykatat gjithsej kanë dënuar 44 persona për keqpërdorim të detyres, 11 prej tyre janë dënuar me gjobë, 4 të dënuar me burgim deri në një vit, një i dënuar me burgim deri në 2 vite, 2 të dënuar me burgim deri në 5 vite, dhe 26 persona janë dënuar me kusht.⁶⁴

Tabela VI: Numri i të dënuarve për veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

	Nr. i Kryerësve	Gjinia		Dënimet								
		Meshkuj	Femra	Gjohë	< 1 vit	1-2 vite	2-5 vite	5-10 vite	10 vite>	kusht	Dënim me gjyqësore	Vërejtje
2014	33	30	3	10	3	/	/	/	/	/	20	/
2015	31	30	1	9	7	1	/	/	/	/	14	/
2016	38	33	5	6	7	1	1	/	/	/	23	/
2017	44	42	2	11	4	1	2	/	/	/	26	/

Nga tabela në vijim vërehet një rritje e kryerësve të kesaj vepre, ku për dallim nga viti 2014 në vitin 2017 kemi 11 persona më tepër të dënuar për këtë veprë. Kryerësit në përgjithësi i takojnë gjinisë mashkullore e më pak asaj femërore. Një numer me të lartë të dënuarave femra kemi në vitin 2016. Për këtë veprë, kryesisht është shqiptuar dënim me gjobë dhe dënim me kusht, e më pak dënim me burgim.

Marrja e rryshfetit është paraparë në atë mënyrë që cdo person zyrtar i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë, kërkon ose pranon ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër për vete apo personin

⁶⁴ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e jurisprudencës për persona madhor, vitet 2015, 2016, 2017

tjetër, ose që pranon ofertën apo premtimin për dhuratë apo përfitim të tillë, në mënyre që personi zyrtar të veprojë apo të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë apo burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre konsiston në a)duke kërkuar dhuratë apo përfitim tjetër b)duke pranuar dhuratë apo përfitim tjetër c)duke pranuar premtim për ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër.⁶⁵

Gjatë vitit 2014, për marrje të ryshfetit janë dënuar 12 persona, prej tyre 5 me dënim me gjobë, 2 me burgim deri në një vit dhe 10 me dënim me kusht.

Në vitin 2015 janë dënuar për këtë vepër 9 persona, 3 me dënim me gjobë, 4 me burgim deri në një vit dhe 2 me dënim me kusht.

Në vitin 2016, gjithsej janë dënuar 11 persona, 2 prej tyre me gjobë, 5 me dënim me burgim deri në një vit dhe 4 persona janë dënuar me kusht.

Në vitin 2017, kemi gjithsej 13 persona të dënuar, 5 me burgim deri në një vit, një me dënim nga deri në 2 vite, një me dënim me burgim deri në 5 vite, një me dënim me burgim deri në 10 vite, një me burgim deri në 15 vite dhe 4 të dënuar me kusht.⁶⁶

⁶⁵ Ismail Zejneli, E drejta penale-pjesa e posacme,Tetove 2007,fq 154

⁶⁶ Agjencia e Statistikave te Kosovës, Statistikat e jurisprudences per persona madhor,vitet 2015, 2016, 2017

Tabela VII: Numri i të dënuarve për veprën penale “Marrje e ryshfetit”

	Nr i Kryerësve	Gjinia		Dënimet							
		Meshkuj	Femra	Gjobë	< 1 vit	1-2 vite	2-5 vite	5-10 vite	10 vite>	Dënim me kusht	Vërejtje gjyqësore
2014	12	10	2	1	7	1	1	/	/	2	/
2015	9	9	/	3	4	/	/	/	/	2	/
2016	11	11	/	2	5	/	/	/	/	4	/
2017	13	13	/	/	5	1	1	1	1	4	/

Nga tabela e mësipërme vërejmë, se numri i të dënuarve përgjjet viteve nuk ka lëvizur tepër. Numri më i lartë i kryerësve paraqitet në vitin 2017 ndërsa numri më i ulët në vitin 2015. Numri i kryerësve të gjinisë mashkullore është dominues në krahasim me gjinimë femërore. Poashtu vërejmë se tek kjo veprë, dënimi me burgim është më i shpeshtë, ku madje në vitin 2017 kemi edhe dënim me burgim me mbi 10 vite.

Ndërsa “Dhënia e ryshfetit” parashihet në atë menyrë që cdo person në menyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i premtan, ofron ose i jep ndonjë dhuratë apo përfitim tjetër personit zyrtar, në mënyrë që ai person të veprojë ose të mos veprojë në pajtim me detyrën e tij zyrtare, dënohet me gjobë ose burgim deri në tre vite.

Veprimi i kryerjës së kësaj vepre penale konsiston në a)dhënies së dhuratës apo përfitimit tjetër

b)premtimin e ndonjë dhurate apo përfitimit tjetër c)ndërmjetësimin e dhënies së ryshfetit.⁶⁷

Në vitin 2014, për vepren penale “Dhënia e ryshfetit”, kemi 21 të dënuar, 18 me gjobë, një me dënim me burgim deri në një vit, dhe dy me dënim me kusht.

Në vitin 2015, për vepren në fjalë, kemi 38 të dënuar, nga ta 25 me gjobë, një me burgim deri në një vit, një me burgim deri në dy vite, dhe 11 të dënuar me kusht.

Në vitin 2016, janë gjithsej 19 të dënuar, ku 13 personave u është shqiptuar dënimi me gjobë, 5 të dënuar me dënim me kusht, dhe një person ka marrë verejtje gjyqësore.

Në vitin 2017, fajtor janë gjetur për dhënie ryshfeti 33 persona, ku me gjobë u dënuar 26 prej tyre ndërsa 7 të tjerë me dënim me kusht.⁶⁸

Tabela VIII: Numri i të dënuarve për vepren penale “Dhënie e ryshfetit”

	Nr i Kryerësve	Gjinia		Dënimet								
		Meshkuj	Femra	Gjobë	< 1 vit	1-2 vite	2-5 vite	5-10 vite	10 vite>	kusht	Dënim me gjyqësore	Verejtje
2014	21	21	/	18	1	/	/	/	/	/	2	/
2015	38	38	/	25	1	1	/	/	/	/	11	/
2016	19	19	/	13	/	/	/	/	/	/	5	1
2017	33	33	/	26	/	/	/	/	/	/	7	/

⁶⁷Ismail Zejneli, E drejta penale-pjesa e posacme,Tetove 2007,fq 154

⁶⁸ Agjencia e Statistikave te Kosovës, Statistikat e jurisprudences per persona madhor,vitet 2015, 2016, 2017

Sipas tabelës së mësipërme vërehet një numër më të lartë të kësaj veprë në vitet 2015 dhe 2017. Tek kjo veprë të gjithë kryerësit brenda periudhës kohore 2014-2018 janë të gjinisë mashkullore. Kryesisht është shqiptuar dënimi me gjobë dhe dënimi me kusht, e më pak dënimi me burgim.

6. Kontrabanda si formë e kriminalitetit ekonomik

Kontrabanda paraqet një dukuri aktuale negative, rrezikshmëria shoqërore e së cilës manifestohet në mënyrë të shumëfishtë. Përmasat e përhapjes së kontrabandës sot, vërejtë në disa forma të saj, e bëjnë atë, me gjasë, trajtën më të organizuar të kriminalitetit, e cila implikon në vetë një mori pasojash negative në shoqëri.⁶⁹

Fillet dhe zhvillimi i kontrabandës janë të lidhura me dukuritë e paraqitjes së kufinjëve shtetëror, përmes të cilëve u krijuan edhe pengesat për këmhim të lirë të mallrave.⁷⁰

Në Kodin penal të Republikës së Kosovës, në nenin 317, paragrafi I, është paraparë vepra penale e Kontrabandimit të mallrave *“Kushdo që duke kaluar vijën kufitare bartë mallra dhe shmang kontrollin doganor, ose kushdo që duke shmangur kontrollin doganor, kryen bartjen e mallrave dhe kalon vijën kufitare, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet”*.⁷¹

Në paragrafin e lartëcekur, janë paraparë dy mënyra të kryerjes të veprës penale të Kontrabandës së mallrave, a) Mënyra e parë e kësaj veprë penale kryhet me bartjen e mallit përtej vijës kufitare dhe shmang kontrollin doganor. Siç shihet, kjo mënyrë e kryerjes së kësaj veprë penale kryhet me veprime kumulative dhe nëse mungon njëri veprim nuk do të ekzistojë vepra penale. Kjo mënyrë e kësaj veprë penale kryhet *me bartje* të mallit përtej kufirit të Republikës së Kosovës dhe njëherësh i *shmang* kontrollit doganor b) Mënyra e dytë e kësaj veprë penale është e kundërta e mënyrës së parë, gjegjësisht duke iu shmangur kontrollit doganor e bartë mallin përtej vijës kufitare. Edhe tek kjo mënyrë vepra kryhet me dy veprime kumulative ashtu që duke iu shmangë kontrollit doganor e kalon vijën kufitare. Veprimet e kryerjes janë *shmangia* nga kontrolli doganor dhe *kalimi* i vijës kufitare. Nëse nuk ekziston njëri veprim kjo formë e veprës penale nuk do të ekzistojë.

⁶⁹ Dr Vesel Latifi, Kriminalistika, Prishtinë, 2012, fq 255

⁷⁰ Dr Veton Vula, vep e cituar, Prishtinë, 2012, fq 67

⁷¹ Kodi penal i Republikës së Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i RKS, Prishtinë, 2013, neni 317

Ndërsa në paragrafin e II të nenin 317 është parapare se *“Kushdo që pa leje përkatëse, shmang kontrollin doganor dhe kalon vijën kufitare duke bartur mallrat, eksportimi apo importimi i të cilave është i ndaluar, i kufizuar apo kërkon leje të posaçme nga organi kompetent, dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë vjet”*

Në këtë paragraf veprimet e kryerjes janë paraparë në mënyrë alternative si vijon: bërje të tregtisë pa leje brenda dhe jashtë territorit të Kosovës dhe në ndonjë mënyrë bart mallra pa iu nënshtruar kontrollit doganor. Të bërit tregti pa autorizim ose pa leje sipas kuptimit të kësaj vepre penale do të thotë veprimtari tregtare lidhur me eksport dhe import të mallrave. Personi i cili e ushtron këtë veprimtari duhet të pajiset me leje apo me autorizim për tregti të jashtme. Vepra penale konsiderohet e kryer me ndërmarrjen veprimeve për eksport apo import pa leje apo pa autorizim të veçantë të cilat janë të përcaktuara me ligj të posaçëm si p.sh, Kodi për akcizën me të cilin kërkohet që për çdo import të produkteve të duhani në territorin e Kosovës të ekzistojë leja për këtë veprimtari. Përveç duhanit, si mallra për të cilat paraprakisht kërkohet licenca apo autorizimi janë derivatet e naftës, kafja, pije alkoolike, disa lloje të lëngjeve etj.

Kodi penal ka paraparë edhe format e kualifikuara të Kontrabandës me mallra, te cilat dënohen me burgim prej një vit deri në dhjetë vite, në ato raste kur: a) kryerësi kalon kufirin me sende, mallra apo substanca të rrezikshme të cilat vënë në rrezik jetën apo shëndetin e njerëzve b) kryerësi kalon kufirin me sende, mallra apo substanca të rrezikshme të cilat paraqesin rrezik për sigurinë e përgjithshme c) kryerësi përdor forcën apo kanosjen serioze ose armën apo mjetin e rrezikshëm gjatë kryerjes së veprës.⁷²

Gjatë vitit 2014, për vepren penale Kontrabandë me mallra, janë dënuar 33 persona, të gjithë meshkuj. Nga ky numër, 16 janë dënuar me gjobë, një kryerës është dënuar me dënim deri në një vit, dhe 16 kryerësve të tjerë u janë shqiptuar dënime alternative.

Në vitin 2015, për Kontrabandë me mallra janë shpallur fajtorë 14 persona, 13 meshkuj dhe një femër. Prej tyre, 7 u dënuan me gjobë, dy me dënime me burgim deri në një vit, dhe 5 të tjerëve u shqiptua dënim me kusht.

Në vitin 2016, për këtë vepër u dënuan 17 persona, 16 meshkuj dhe një femër. Prej tyre, 5 u dënuan me gjobë, 2 me dënim me burgim deri në një vit, dhe u shqiptuan 10 dënime me kusht.

⁷² Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, Komentari i Kodit penal të Republikës së Kosovës, Botimi I, Prishtinë, 2014, fq 878

Në vitin 2017, u gjetën fajtorë 18 persona, të gjithë meshkuj. Nga ta 4 u dënuan me gjobë, 3 me burgim deri në një vit, dhe 11 u dënuan me kusht.⁷³

Tabela IX: Numri i të dënuarve për veprën penale “Kontrabandë me mallra”

	Nr i Kryerësve	Gjinia		Dënimet								
		Meshkuj	Femra	Gjobë	< 1 vit	1-2 vite	2-5 vite	5-10 vite	10 vite>	kusht	Dënim me alternativ	Dënim tjetër
2014	33	33	/	16	1	/	/	/	/	/	13	3
2015	14	13	1	7	2	/	/	/	/	/	5	/
2016	17	16	1	5	2	/	/	/	/	/	10	/
2017	18	18	/	4	3	/	/	/	/	/	11	/

Nga tabela e mësipërme vërejmë se në vitin 2014 kemi numri më të lartë të kryerësve të dënuar. Ky numer ulet dukshëm në vitin 2015 dhe pastaj kemi një ngritje të lehtë përgjatë viteve 2016 dhe 2017. Njëjtë edhe tek kjo veprë, vërejmë se dënimet me së shumti të shqiptuara janë dënimi me gjobë dhe dënimi me kusht.

⁷³ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Statistikat e jurisprudencës për persona madhor, vitet 2015, 2016, 2017

KAPITULLI IV

1. Luftimi dhe parandalimi i kriminalitetit ekonomik

Përderisa kriminaliteti ekonomik sot ka një shtrirje ndërkombëtare, është e domosdoshme që lufta kundër tij të mos përqëndrohet vetem brenda kufinjëve të një shteti, mirëpo të ekzistojë një bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtare midis vendeve të ndryshme, në luftimin dhe parandalimin e tij.

Strategjia e luftës kundër kriminalitetit të organizuar duhet të jetë e orientuar, para së gjithash, në fushën e rregullativës financiare, zhvillimit shoqëror e ekonomik dhe të demokracisë, minimizimit të mundësive objektive për keqpërdorimin e konjunkturave tregtare dhe shoqërore e politike, aftësimin profesional të kuadrit, koordinimit dhe bashkëpunimit në planin ndërkombëtar.

Ekzistojnë tri mënyra të luftës kundër kriminalitetit të organizuar. Mënyra e parë është mënyra amerikane, sipas së cilës kriminelëve u konfiskohet gjithë pasuria dhe paratë. Mënyra e dytë është që vendeve që e mbështesin hapur kriminalitetin e organizuar t'u tërhiqet vërejtja se nuk do të tolerohen (Pakistani, Afganistani dhe vendet e Azisë Qendrore e Jugore). Mënyra e tretë ka të bëjë me vendet në tranzicion, të cilat duhet ta zgjidhin këtë çështje sa më parë, sepse këto vende nuk mund të mbështesin kriminalitetin e organizuar dhe të integrohen në bashkësinë ndërkombëtare⁷⁴

Kriminaliteti ekonomik dhe korrupsioni është një problem shqetësues për ekonominë e shumë shteteve. Sipas një studimi të kryer nga Banka Botërore (1998), më të korrumpuarit rezultojnë punjonësit e doganave, të pasuar nga ata të drejtësisë dhe të policisë. Disa të dhëna të hulumtuara, profesionalisht dhe shkencërisht të analizuar mbi gjendjen dhe ecurinë e korrupsionit në një vend, ilustrojnë dhe pasqyrojnë këtë dukuri në menyrë të mjaftueshme për vlerësime dhe programime të masave të parandalimit dhe luftimit të korrupsionit. Edhe studimet e tjera të kryera më vonë, raportet e institucioneve monitoruese vendëse dhe të huaja tregojnë se korrupsioni po dëmton rëndë ekonominë e shtetit dhe ndikon në uljen e

⁷⁴ Dr Mersida Suceska, vep e cituar, Prishtinë, 2006, fq 44

efektivitetit të luftës kundër krimit të organizuar.⁷⁵

Parandalimi dhe eliminimi i kriminalitetit ekonomik nxit nevojën për të krijuar më shumë trupa dhe institucione të specializuara brenda cdo sistemi, të cilat do të jenë në gjendje të ndjekin, zbulojnë dhe të sanksionojnë këtë lloj kriminaliteti.”Lufta kundër korrupsionit, si fenomen ndërkombëtar, kërkon jo vetëm një politikë efektive brenda vendit, por edhe një bashkëpunim ndërkombëtar, bazuar në Konventën Evropiane.Rol të rëndësishëm në parandalimin e krimit ekonomik kanë drejtpërdrejtë:Gjykatat, policia, policia financiare, dogana dhe shërbimet tjera në mënyrë indirekte, menaxhimi i të ardhurave publike etj.⁷⁶

Në Republikën e Kosovës, ka organe të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë kompetencë zbulimin e kriminalitetit në përgjithësi, përfshirë edhe kriminalitetin ekonomik:

- 1) Gjykatat-të cilat e ushtrojnë funksionin e gjykimit.Sipas nenit 103 të Kushtetutës së Kosovës organizimi, funksionimi dhe jurisdiksioni i Gjykatës Supreme dhe i gjykatave tjera rregullohet me ligj
- 2) Prokurori i shtetit- i cili ushtron funksionin e ndjekjes penale.Në të drejtën tonë Prokurori i shtetit është organ i pavarur, përgjegjës për hetimin e veprave penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare apo me propozimin e të dëmtuarit.Funksionimi dhe organizimi i prokurorit të shtetit është i rregulluar me Ligjin për prokurorin e shtetit.
- 3) Policia e Kosovës-e cila konsiderohet si organ më i vjetër në luftë kundër kriminalitetit dhe ka për qëllim që ti ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim që të zbulohet kryerësi i vepres penale, si dhe të bëjë sigurimin e të gjitha dëshmive të nevojshme për zhvillimin e procedurës.Funksionimi dhe organizimi i policisë është i rregulluar me Ligjin për policinë.
- 4) Dogana-e cila përveq mbledhjes së taksave doganore, kontrollimin e eksport/importit dhe mbrojtjen e ekonomisë ka rol të madh edhe në luftimin e aktiviteteve ilegale dhe krimeve kufitare.
- 5) Njësia për inteligjencë financiare-është institucioni qendror i pavarur kombëtar në kuadër të Ministrisë së Financave,përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin dhe

⁷⁵ Ismail Zejneli & të tjerë, Kriminaliteti i organizuar-aspekte juridike, Tetovë, 2009, fq 116-117

⁷⁶ Ismail Zejneli, Economic Criminality in Transition Countries- Aspects of the Legal and Economic Analysis, Rome, Italy, 2013

shpërndarjen tek autoritet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit.

- 6) Agjencia kundër korrupsionit- e cila ka kompetenca në raportimin, zbulimin dhe hetimin e korrupsionit.
- 7) Administrata Tatimore e Kosovës (ATK)-e cila luan rol të rëndësishëm në hetimin e veprave penale tatimore
- 8) Inspektorati Policor i Kosovës- poashtu është një organ që në raste të caktuara ka rol të rëndësishëm për luftimin e kriminalitetit ekonomik, më saktësisht në ato raste kur si kryerës të këtyre veprave na paraqiten pjestarët e Policisë.

2. Roli i Policisë në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit ekonomik

Policia është organ shtetëror që kujdeset për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti, mbajtjen e rendit dhe qetësisë publike si dhe sigurimin e rendit të caktuar shtetëror. Policia është një institucion tradicional i njohur për mbrojtjen e rendit shoqëror në të gjitha tipet historike shoqërore dhe në të gjitha vendet në botë. Në të gjitha vendet, duke llogaritur edhe shoqëritë bashkëkohore, policia përveç në aspektin formal, ka të njëjtat përcaktime shoqërore dhe përafërsisht kryen të njëjtat funksione dhe detyra.⁷⁷

Veprimtaria e policisë është e shumëfishtë. Policia, duke vepruar në parandalimin dhe zbulimin e krimit i ofron prokurorit të shtetit dhe gjykatës material të nevojshëm për fillimin e procedurës penale, gjatë zhvillimit të procedurës penale ofron ndihmë kriminalistike, ofron ndihmë për ekzekutimin e vendimeve, jep të dhëna nga evidencat e caktuara, në kushte të caktuara ligjore dhe nën mbikqyrjen e prokurorit të shtetit policia kryen edhe veprime hetimore.⁷⁸

Në çdo shoqëri të organizuar në shtet, policisë i takon vend i posacëm në luftë kundër kriminalitetit. Për tu kundërvën me sukses kriminalitetit, policia është e autorizuar që të ndërmarrë një aktivitet të dënduar kundër tij. Autorizimet e policisë nuk janë cdoherë të njëjta,

⁷⁷ Vesel Latifi, Politika kriminale, Prishtinë, 2011, fq 112-113

⁷⁸ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2016, fq 153

madje as në kuadër të një shteti në distanca kohore dhe janë të kushtëzuara me qëndrime dhe zgjidhje kriminalo-politike në luftë kundër kriminalitetit.

Sipas KPP të Republikës së Kosovës, policia pas pranimit të informatës për veprë penale të dyshuar, heton nëse ka dyshim të arsyeshëm që një veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare të jetë kryer. Për të vertetuar nëse ekziston dyshim i arsyeshëm se një veprë penale dhe ndërmerret të gjitha masat e nevojshme që: 1) të zbulojë vendodhjen e kryerësit 2) të ndalojë kryerësin ose ndihmësin e tij nga fshehja ose arratisja 3) të zbulojë dhe ruaj gjurmët dhe provat të tjera të veprës penale dhe sendet të cilat mund të shërbejnë si provë dhe 4) të mbledh të gjitha informacionet të cilat mund të përdoren në procedurën penale.⁷⁹

Lufta kundër kriminalitetit ekonomik ka qenë ndër prioritet kryesore të Policisë së Kosovës. Në vitin 2016 në fushën e luftimit kundër krimeve ekonomike dhe korrupsionit, janë hetuar 616 raste, ngritur 416 kallëzime penale ndaj 777 personave, janë arrestuar 139 persona, janë realizuar 19 operacione, 319 bastisje, si dhe janë goditur 14 grupe të organizuara kriminale.⁸⁰

Në vitin 2017 në fushën e luftimit kundër krimeve ekonomike, korrupsionit dhe pasurisë janë hetuar 607 raste, janë ngritur 370 kallëzime, janë arrestuar 91 persona të dyshuar, janë realizuar 9 operacione dhe 29 plane operative, si dhe janë neutralizuar 7 grupe të organizuara kriminale.⁸¹

3. Roli i Prokurorisë në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit ekonomik

Prokuroria është institucion klasik i juridikaturës penale, i cili paraqitet qysh para 150 vjetësh, me qëllim që tu kundërvihet rreziqeve të veprimeve inkuizitore, që ka mbrojtur po në ato duar në duart e gjykatësve-ndricimin e veprave penale dhe gjykimin sipas tyre. Prej atëherë prokuroria zhvillohet në mënyrë specifike në disa vende ose grupe vendesh, varësisht nga kushtet e ndryshme të jetës dhe të zhvillimit.⁸²

⁷⁹ Po aty, fq 305

⁸⁰ Raporti i punës i Policisë së Kosovës 2016

⁸¹ Raporti i punës i Policisë së Kosovës 2017

⁸² Vesel Latifi, Politika kriminale, Prishtinë, 2011, fq 127

Autorizimet e prokurorive në shumë shtete të sotme evropiane janë të rregulluara me legjislacionin penal, ashtu që prokurori ka rol zotërues në hetimet paraprake. Ai ka të drejtë të kryejë vet cdo veprim hetimor që ë cmon të nevojshëm për të vertetuar praninë e veprës penale. Ky parim “ndeshet” me dy parime të tjera: me parimin sipas të cilit policise gjyqësore i janë dhënë haësira të mëdha hetimesh “me iniciative” dhe në parimin sipas të cilit prokurori kërkon nga ajo të kryejë veprime të deleguara posacërisht. Prokurori ka të drejtë të vertëtojë kryerjen e vepres penale në përputhje me rolin që ka si drejtues i veprimtarisë hetimore. Veprimtaria juridike dhe kriminalistike e prokurorit të shtetit shtrihet në shumë drejtime që kanë për qëllim luftimin e kriminalitetit.⁸³

Në të drejtën tonë Prokurori i shtetit është organ i pavarur, përgjegjës për hetimin e veprave penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare apo me propozimin e të dëmtuarit. Detyrat dhe kompetencat e prokurorëve të shtetit përfshijnë ushtrimin funksioneve prokuroriale në menyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme, gjithnjë duke zbatuar standarte të larta dhe duke manifestuar sjellje të ndershme dhe profesionale në jetën personale. Në këtë drejtim ai duhet të ndërmerret masat e nevojshme lidhur me zbulimin e veprave penale dhe gjetjen e kryerësve të veprave penale, për mbikqyrjen e punës së policisë gjatë hetimit të personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale dhe për mbledhjen e të dhënave dhe informacioneve për fillimin e procedurës penale, pas hetimit ngritë dhe përfaqëson akuzën në gjykatën kompetente, bën ankesë kundër vendimeve gjyqësore që nuk kanë formën e prerë dhe paraqet mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore të formës së prerë.⁸⁴

Trajtimi i lëndëve nga fusha e kriminalitetit ekonomik dhe korrupsionit është ndër prioritetet kryesore të këtij institucioni. Në vitin 2016, prokuroritë kanë zgjidhur 407 kallëzimeve penale me 512 persona për veprat penale të Krimeve ekonomike. Të pranuar në 2016 ishin 343 kallëzime penale me 487 persona ndërsa të pazgjidhura në fund të vitit 2016 kanë mbetur 467 me 750 persona. Sa i përket veprave penale të korrupsionit, prokuroritë kanë zgjidhur 468 kallëzimeve penale me 1164 persona për veprat penale të Korrupsionit. Të pranuar në 2016 ishin 438

⁸³ Vesel Latifi, Politika kriminale, Prishtinë, 2011, fq 130

⁸⁴ Ejup Sahiti, Rexhep Murati, vep e cituar, Prishtinë, 2016, fq 148

kallëzime penale me 849 persona ndërsa të pazgjidhura në fund të vitit 2016 kanë mbetur 447 me 1248 persona.

Të dhënat për efikasitetin e prokurorit në zgjidhjen e lëndëve nga fusha e kriminalitetit ekonomik dhe korrupsionit shprehen si në vijim

- Prokuroritë kanë zgjidhur 106.84% të numrit të kallëzimeve penale për veprat penale të Korrupsionit ndërsa, 137.10% të personave.
- Prokuroritë kanë zgjidhur 118.65% të numrit të kallëzimeve penale për veprat penale të Krimeve ekonomike ndërsa, 105.13% të personave.⁸⁵

Në vitin 2017, prokuroritë kanë zgjidhur 412 kallëzimeve penale me 550 persona për veprat penale të Krimeve ekonomike. Të pranuar në 2017 ishin 389 kallëzime penale me 528 persona ndërsa të pazgjidhura në fund të vitit 2017 kanë mbetur 361 me 619 persona. Sa i përket veprave penale të korrupsionit, prokuroritë kanë zgjidhur 412 kallëzimeve penale me 902 persona për veprat penale të Korrupsionit. Të pranuar në 2017 ishin 402 kallëzime penale me 668 persona ndërsa të pazgjidhura në fund të vitit 2017 kanë mbetur 301 me 715 persona.

Në vitin 2017 të dhënat për efikasitetin e prokurorit në zgjidhjen e lëndëve nga fusha e kriminalitetit ekonomik dhe korrupsionit shprehen si në vijim

- Prokuroritë kanë zgjidhur 102.4% të rasteve përkatësisht 135% për persona për lëndët e Korrupsionit.
- Prokuroritë kanë zgjidhur 128.47 % të rasteve përkatësisht 106% për persona, për lëndët e Krimeve Ekonomike.⁸⁶

4. Roli i Intelejencës Financiare në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit ekonomik

Njësia e inteligjencës financiare e Republikës së Kosovës është institucioni qendror i pavarur kombëtar në kuadër të Ministrisë së Financave, përgjegjës për kërkimin, marrjen, analizimin

⁸⁵ Raporti i Prokurorit të shtetit të Republikës së Kosovës 2016

⁸⁶ Raporti i Prokurorit të shtetit të Republikës së Kosovës 2017

dhe shpërndarjen tek autoritetet kompetente dhe bërjen publike të informacionit në lidhje me pastrimin potencial të parave dhe financimin e terrorizmit.

Neni 14 i ligjit kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i Kosovës përcakton detyrat dhe kompetencat e NJIF-K:

- të grumbullojë informacione që kanë lidhje me aktivitetet e pastrimit të parave dhe veprave të ndërlidhura penale ose financimin e aktiviteteve terroriste.
- të kryejë analiza strategjike të informatave që i grumbullon dhe pranon, për parandalimin dhe luftimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit.
- të kërkojë nga subjektet raportuese të dhëna, dokumente dhe informata që i duhen me qëllim që të ushtrojë detyrat që dalin nga ky ligj
- të kërkojë nga organet publike ose qeveritare të dhëna, dokumente dhe informata që i duhen me qëllim që të ushtrojë detyrat që dalin nga ky ligj dhe qasje në bazat e të dhënave të cilat mbahen nga këto organe.
- të përpilojë informata, statistika, raporte dhe, duke u bazuar në ato, t'u bëjë rekomandime Ministrisë së Financave, Ministrisë së Drejtësisë, Policisë së Kosovës, Doganave të Kosovës dhe personave apo organeve të tjera relevante, në lidhje me masat që duhet të merren dhe legjislacionin që duhet të miratohet për të luftuar pastrimin e parave, veprat e ndërlidhura penale dhe financimin e terrorizmit.
- të organizojë dhe kryejë trajnime të rregullta, përfshirë vetëdijesim dhe sensibilizim në lidhje me parandalimin e pastrimit të parave, veprave të ndërlidhura penale dhe financimit të terrorizmit si dhe detyrimet e subjekteve raportuese.
- të shpërndajë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, rezultatet që dalin nga analizat dhe çdo raport apo informacion të nevojshëm për autoritetet përkatëse.
- të miratojë akte nënligjore, të lëshojë urdhra dhe udhëzues mbi çështjet që kanë të bëjnë me sigurimin ose promovimin e pajtueshmërisë me këtë ligj.
- të lëshojë urdhër për moskryerjen e transaksionit në pajtim me këtë ligj apo të kërkojë nga subjektet raportuese të monitorojë llogaritë apo marrëdhënien e biznesit për një periudhë kohore deri në tre muaj.

- të mbikëqyrë dhe monitorojë subjektet raportuese për sa i përket pajtueshmërisë me këtë ligj si dhe me akte nënligjore, urdhrat dhe urdhëresat, që rrjedhin dhe parashihen me këtë ligj.
- Të kryejë funksione tjera të parapara me këtë ligj.⁸⁷

Sipas këtij ligji, subjekte raportuese tek NJIF-K konsiderohen:

- bankat,
- institucionet financiare,
- kazinotë,
- personat fizik apo juridikë që tregtojnë mallra dhe pranojnë pagesa mbi 10 mijë euro, kontabilistët
- këshilltaret tatimorë
- Avokatët dhe notëret kur kryejnë transaksione në lidhje me aktivitetet si patundshmëri, letra me vlerë, blerjen dhe shitjen e subjekteve afariste.
- Trusti
- OJQ
- Shitësit e metaleve dhe gurëve të cmuar.⁸⁸

5. Rëndësia e masave të posacme hetimore në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit ekonomik

Në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit ekonomik, rol kyç luajnë masat e posacme hetimore. Kodi procedurës penale të Republikës së Kosovës, ka paraparë një numër të masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, në nenin 87, ku përfshihen:

- *Vëzhgimin e fshehtë fotografik ose me video*
- *Monitorimi i fshehtë i bisedave*
- *Kontrollin e dërgesave postare*

⁸⁷ Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i Republikës së Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i RKS, Prishtinë, 2016, neni 14

⁸⁸ Po aty, neni 16

- *Përgjimin e telekomunikimeve*
- *Përgjimin e telekomunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik*
- *Dërgimin e kontrolluar të dërgesave postare*
- *Shfrytëzimin e mjeteve për përcjellje të vendodhjes*
- *Blerjen e simuluar të ndonjë sendi*
- *Simulimin e veprës së korrupsionit*
- *Hetimin e fshehtë*
- *Regjistrimin e thirrjeve telefonike dhe*
- *Zbulimin e të dhënave financiare⁸⁹*

Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit zbatohen para ose gjatë zbatimit të hetimit formal. Në rastin kur prokurori i shtetit ka dyshim të bazuar se është kryer veprë penale për të cilën KPPK parasheh mundësin e zbatimit të masës së fshehtë, përkohsisht mund të autorizojë apo të kërkojë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të autorizojë masë të fshehtë dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit.

Në lufimin e kriminlatiteti ekonomik, është tepër e rëndësishme të zbulohet nga ana e organeve hetimore, se personi i dyshuar për keto krime posedon të ardhura të paligjshme. Për këtë arsye masat e posaçme të hetimit financiar janë të domosdoshme. P.sh: provat që tregojnë se një nëpunës publik ka depozituar shuma të mëdha në llogari bankare, ka blerë artikuj të shtrenjtë duke paguar me para në dorë ose ka shpenzuar shumë më tepër para sesa ka fituar nëpërmjet burimeve të ligjshme të të ardhurave, mund të jenë plotësues të fortë të dëshmive apo provave të tjera që tregojnë se i pandehuri ka marrë rryshfet ose ka kryer ndonjë aktivitet tjetër të paligjshëm.

Është e rëndësishme të cekën shkurtimisht disa metoda të hetimit financiar të cilat hetuesi mund ti aplikojë gjatë zhvillimit të tij kundrejt një të dyshuari.

1. Metoda direkte e të provuarit është mënyra më e thjeshtë për të zbuluar se i dyshuari ka marrë përfitime të paligjshme. Kjo metodë nënkupton mbledhjen e provave që lidhen drejtpërdrejt me krimin. P.sh: prova se i pandehuri ka depozituar para në bankë

⁸⁹ Kodi i procedurës penale i Republikës së Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i RKS, Prishtinë, 2013, neni 87

pikërisht në ditët kur dëshmitarët ia kanë paguar atij ryshfete, do të mbështeste fuqimisht dëshmitë e këtyre dëshmitarëve.

2. Metoda e vlerës neto është një tjetër metodë e aplikueshme. Përdorimi i metodës së vlerës neto, si metodë të provuari, është i përshtatshëm kur i pandehuri po grumbullon pasuri dhe nuk ka të dhëna të mjaftueshme për të përcaktuar burimin e parave të përdorura për të blerë këto pasuri. Rritja e vlerës neto për një periudhë të caktuar kohe, minus të ardhurat e ligjshme që njihen dhe para të tjera të marra në mënyrë të ligjshme, janë baraz me të ardhura të paligjshme.
3. Metodë tjetër është edhe metoda e shpenzimeve totale, që është e dobishme kur është e qartë se i pandehuri bën një jetë përtej mundësive të tij, por nuk blen pasuri që janë të dukshme. Kjo metodë bazohet në një koncept të thjeshtë: meqë shpenzimet e të pandehurit, në një periudhë të caktuar kohe, tejkalojnë të ardhurat e tij nga puna ose burime të tjera të njohura, ai duhet të ketë edhe një burim të panjohur të ardhurash. Sigurisht, burimet e panjohura do të shpjegohen me të njëjtat prova që provojnë aktivitetin kriminal, për të cilin ai po hetohet.
4. Metoda e depozitave bankare-Edhe kjo metodë merr në shqyrtim burimet e njohura dhe të panjohura, por analizon veprimtaritë bankare të të pandehurit dhe jo thjesht pasuritë dhe shpenzimet e tij. Kjo metodë funksionon mirë edhe nëse kombinohet me analizën e shpenzimeve me para në dorë, pasi hetimi përqëndrohet në depozitim të parave, dhe në shpenzime të tjera me para në dorë nga i pandehuri në një periudhë kohore të caktuar. Megjithatë, metoda e depozitave bankare mund të përdoret vetë, nëse i pandehuri ka llogari bankare dhe i përdor ato rregullisht. Kjo metodë analize është veçanërisht e dobishme kur i pandehuri ka një pagë të qëndrueshme, e cila depozitohet në llogarinë e tij bankare.
5. Metoda e shpenzimeve me para në dorë-kjo metodë mund të jetë veçanërisht e dobishme në çështje korrupsioni apo çështje të tjera që kanë të bëjnë me nëpunës publikë dhe fitime të paligjshme prej tyre. Kjo lloj analize finansiare ka të bëjë vetëm me përdorimin e parave në dorë nga i pandehuri: p.sh: blerje me para në dorë, depozitime parash në llogari bankare, tërheqje parash nga llogaritë bankare, tërheqja e

rrogave, marrja e dhuratave ose huave me para në dorë etj. Duke llogaritur të gjitha shpenzimet e kryera me para në dorë nga i pandehuri (depozitimi i parave në llogari bankare, blerje sendesh ose shërbimesh me para në dorë, pagesa e faturave me para në dorë etj) dhe duke zbritur prej tyre të gjitha burimet e njohura të të ardhurave (paga, para të kursyera më parë, etj), hetuesi mund të përcaktojë sasinë e shpenzimeve me para në dorë të të pandehurit që tejkalojnë të ardhurat e tij të ligjshme. Diferenca ndërmjet këtyre të dyjave mund të përfaqësojë ryshfete të paguara me para në dorë ose të ardhura të tjera, të fi tuara në mënyrë të paligjshme nga sjellja kriminale e të pandehurit.⁹⁰

⁹⁰ Udhezuesi për hetimin e korrupsionit dhe krimit financiar, Botimet Dudaj, Tiranë, 2010, fq 127-153

Perfundim

Kriminaliteti ekonomik, në venci korrupsioni mbeten sfidat kryesore për të ardhmen e Republikës së Kosovës. Të dhënat statistikore nga Policia, Prokuroria dhe Agjencia e Statistikave tregojnë se ndër format e kriminalitetit ekonomik me përhapjen më të gjerë në Kosovë janë shmangia nga tatimi, kontrabanda, korrupsioni dhe shpërlarja e parave. Një karakteristikë e krimeve ekonomike në vendin tonë, është se numri i krimeve për të cilat është zhvilluar një procedurë gjyqësore, paraqet vetëm majën e “ajsbergut”, ngase realisht numri i tyre është shumëfish më i lartë. Pra mund të vijmë në përfundim se numri me i madh i krimeve ekonomike që kryhen në vendin tonë hyjnë në kategorinë e kriminalitetit të errët, i cili nuk zbulohet dhe për të nuk zhvillohet një procedurë gjyqësore.

Si shkaqe të kriminalitetit ekonomik në Kosovë mund të numërohen: mosfunksionimi i ligjit dhe sistemit të drejtësisë, mungesa e legjislacionit efikas, gjendja e rëndë ekonomike dhe sociale, morali i dobët, periudha e tranzicionit, periudha e pasluftës, pagat e vogla të nëpunëve shtetëror, dëshira për pasurim të shpejtë.

Luftimi dhe parandalimi i kriminalitetit ekonomik paraqet shumë vështirësi në aspektin praktik, kjo ngase vendit tonë i mungojnë shpeshherë mekanizmat, kuadrot si dhe legjislacioni i nevojshëm. Për këtë arsye Republika e Kosovës duhet të përqendrohet seriozisht në luftimin e kriminalitetit ekonomik, duke ndërrmarre një sërë masash dhe veprimesh. Pikësëpari nevojitet ngritja e vetëdijes shoqërore mbi rrezikun dhe dëmet që i shkakton krimi ekonomik dhe korrupsioni procesit të shtetndërtimit. Ky vetëdijësim mund të arrihet vetëm nëpërmjet një bashkëpunimi të ndërsjelltë ndërmjet organeve të drejtësisë, mediave, institucioneve arsimore. Poashtu në këtë aspekt, rol të rëndësishëm luan edhe përmisimi i transparencës dhe llogaridhënies nga ana e të gjithë organeve shtetërore.

Republika e Kosovës duhet të vazhdojë në forcimin e kapaciteteve të saja kundër këtyre fenomeneve. Së pari duhet të miratohet legjislacioni i nevojshëm i cili është parakushti kryesor për luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit ekonomik. Në këtë drejtim primar është miratimi i ligjit anti-mafia, që do të mundësonte konfiskimin e pasurisë të paligjshme të personave që dyshohet që janë të përfshirë në organizime kriminale dhe afëra korrupsioni. Gjithashtu duhet

të parashihet edhe permisimi i mekanizmave që merren me hetimin dhe ndjekjen e krimit ekonomik (policisë, prokurorisë, intelegjencës), duke krijuar në kuadër të tyre task-forca me individë të specializuar në këtë fushë, të cilët do të kishin njohuritë e mjaftueshme për të zbuluar dhe ndjekur keto lloj krimesh.

Së fundmi një rol të përmadhim luan edhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Kosovë në këtë aspekt duhet të implementojë në legjislacionin e saj vendor të gjitha konventat dhe dokumentet ndërkombëtare, e posaçërisht legjislacionin e Bashkimit Europian në fushën e kriminalitetit ekonomik-financiar dhe korrupsionit. Poashtu duhet të merret të gjitha masat e duhura për të përshpejtuar anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare të ngarkuara me luftimin e kriminalitetit si Interpol dhe Europol, ngase anëtarësimi në keto organizma do ishte një ndihmesë e madhe në luftimin e këtyre dukurive. Në të gjitha rastet, Kosova duhet të tregohet e gatshme për të mësuar nga përvojat e vendeve të zhvilluara në luftimin dhe parandalimin e kriminalitetit ekonomik dhe korrupsionit, e veçanërisht të atyre vendeve që në të kaluarën janë përballuar me këto sfida dhe i kanë kaluar me sukses.

Bibliografia

- Mersida SUÇESKA Bazat e Kriminalitetit Ekonomik, Prishtinë, 2006
- Ismail Zejneli, E drejta penale-pjesa posacme, Tetove, 2007
- Ragip Halili , Kriminlogjia, Prishtine, 2015
- Ejup Sahiti, Rexhep Murati, E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2016
- Vesel Latifi ,Kriminalistika, Prishtine, 2012
- Vesel Latifi, Politika Kriminale, Prishtine, 2011
- Veton Vula, Kriminaliteti i organizuar, Prishtinë, 2013
- Ismail Zejneli&tjere, Krimi i organizuar-aspekte juridike, Tetove,2009
- Ismail Zejneli, Economic Criminality in Transition Countries- Aspects of the Legal and Economic Analysis, Rome, Italy, 2013.
- Adnan.J&Ismail.Z,Disa veshtrime ne lidhje me kriminalitetin ekonomik ne Maqedoni ne periudhen e tranzicionit. In E drejta(LAË), Prishtine, 2011
- Luan Gjonca, Korrupsioni, Tiranë, 2004
- Cristi Danilet, Korrupsioni dhe Antikorrupsioni në sistemin e drejtësisë, Tiranë, 2011
- Edëin H. Sutherland, ËHITE-COLLAR CRIMINALITY, American Sociological Revieë, Vol. 5, No. 1 (shkurt., 1940)
- Ismet Salihu, Hilmi Zhitija, Fejzullah Hasani, Komentari i Kodit penal të Republikës së Kosovës, Botimi I, Prishtinë
- Udhezuesi per hetimin e korrupsionit dhe krimet financiar, Botimet Dudaj, Tiranë, 2010
- Doktoratura, Ardit Mustafaj, Studim juridiko-penal dhe kriminologjik i kriminalitetit ne sferen ekonomike-financiare, Tiranë, 2017
- Ilir Islami,Krimi ekonomiki-financiar si pengese per zhvillimin e Kosoves,
- Këshilli i Europes, Raporti mbi gjendjen e krimet të organizuar dhe krimet ekonomik ne Evropën Juglindore, Strasburg, 2006
- Kipred, Reagimi ndaj Pastrimit të parave në Kosovë, në mes të politikës dhe praktikave, Prishtinë, 2016
- Arben Rakipi, Korrupsioni dhe Evazioni Fiskal,Tiranë,2003

- Agjencia e Statistikave te Kosovës, Statistikat e jurisprudences per persona madhor 2014
- Agjencia e Statistikave te Kosovës, Statistikat e jurisprudences per persona madhor 2015
- Agjencia e Statistikave te Kosovës, Statistikat e jurisprudences per persona madhor 2016
- Raporti i Prokurorit të shtetit 2016
- Raporti i Prokurorit të shtetit 2017
- Raporti i punës i Policisë së Kosovës 2016
- Raporti i punës i Policisë së Kosovës 2017
- Financial crime in the UK (England and Wales):overview by Christopher David, Alison Geary, David Rundle, Lloyd Firth, Leila Gaafar, Fred Saugman, and Anna Gaudoin, Eilmer Hale

Ligje dhe Konventa

- Kodi penal i Republikës së Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i RKS, Prishtinë, 2013
- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Tiranë, 1991
- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, i miratuar nga Kuvendi i RM, Shkup,
- Kodi Penal i Bosnjës dhe Herzegovines, i miratuar nga Kuvendi i BeH, Sarajeve, 2003, i amandamentuar përseri në vitin 2015
- Kodi Penal i Zvicrës, i miratuar nga Asambleja Federale e Konfederatës Zvicerrane, Bernë, 1937
- Ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i Republikës së Kosovës, i miratuar nga Kuvendi i RKS, Prishtinë, 2016
- Konventa për shpërlarjen e parave, zbulimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë së fituar me vepra penale
- Konventa e OKB-së kundër krimit të organizuar transnacional
- Konventa e Këshillit të Europës për shpërlarjen e parave, zbulimin, sekuestrimin dhe konfiskimin e dobisë nga vepra penale dhe finansimi i terrorizmit.

Burime nga Interneti

- <https://study.com/academy/lesson/history-of-white-collar-crime-developments-examples.html>
- <https://www.unodc.org/unodc/en/money-laundering/globalization.html>